



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.
2. Projektligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Nard Ndoka, Pirro Lutaj

Mungon:

Tom Doshi

Të ftuar:

Ylli Manjani – ministër i Drejtësisë

Idlir Peçi - zëvendësministër i Drejtësisë

Irena Beqiraj – zëvendësministre e Financave

Katrin Treska – përfaqësuese nga Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Sonila Qato - drejtore e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Olsi Raklli – përfaqësues nga AKKP-ja

Denada Stoja – përfaqësuese e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Enis Trushi - përfaqësuese e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fati

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Zonja dhe zotërinj deputetë, mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit, ku si pikë të parë kemi projektligjin “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Kjo është nismë e qeverisë. Si përfaqësues i qeverisë dhe për të prezantuar projektligjin, për t’u dhënë përgjigje pyetjeve të mundshme, komenteve të deputetëve është i pranishëm ministri i Drejtësisë, zoti Ylli Manjani. Meqenëse është mbledhja e parë e komisionit, ku zoti Manjani vjen si ministër i Drejtësisë, besoj kam edhe mirëkuptimin tuaj, duke përfutur nga ky rast, dua t’i uroj atij suksese në këtë detyrë të vështirë dhe me shumë përgjegjësi, për më tepër në një moment shumë të rëndësishëm, siç janë zhvillimet në fushën e drejtësisë. Urime, zoti Manjani, për detyrën!

Së bashku me ministrin është edhe zëvendësministri i Drejtësisë, zoti Ildir Peçi, i cili ka qenë i pranishëm edhe herë tjetër në mbledhjen e komisionit dhe është i njohur për kolegët.

Është e pranishme edhe drejtoresha e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zonja Sonila Qato.

Para se të bëjë një parashtrësë ministri, zoti Majko, në cilësinë e relatorit, ka kërkuar fjalën për procedurë.

Pandeli Majko – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dje ju bëra një kërkesë, të cilën po e përsëris edhe sot. Në emër të dy relatorëve, duke qenë se projektligji është i një rëndësie tepër të veçantë dhe prek interesat e një shtrese të gjerë të popullsisë, në komision, në dijeninë time, kanë ardhur kërkesa për seancë dëgjimore nga disa grupe interesi të shpronësuarish, po ashtu edhe nga Avokati i Populli, do të propozoja që ditën e premte t’i ftojme të gjitha palët e interesuara që kanë shprehur interes për një seancë dëgjimore. Kjo do të ishte me shumë interes dhe do t’i shërbente diskutimit të këtij projektligji kaq të rëndësishëm.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Ka mendim ndryshe për këtë kërkesë? Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e mbështes plotësisht relatorin, është me shumë rëndësi që për këtë çështje, për këtë propozim, për të cilin do të ketë shumë kundërshtime, do të ngrihen shumë probleme e shqetësime, përpara se të sqarohemi ne nga Agjencia, e rëndësishme është të sqarohemi edhe nga grupet e interesit, nga ata që do të preken drejtpërdrejt dhe do t’u cenohet e drejta. Ndaj mendojmë që propozimi i relatorit është me vend dhe ne e mbështesim atë. Le të përpiqemi të

gjejmë rrethin më të plotë të organizatave që do ta na japin opinionin e tyre në lidhje me këtë çështje.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Meqenëse të gjithë janë dakord, atëherë ditën e premte, pasi të konkordojmë edhe me përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe grupeve të interesit që kanë kërkuar të dëgjohen në këtë komision, do të njoftoni për orën e seancës dëgjimore.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Fjalën e ka zoti ministër për të bërë një parashtrësë të projektligjit.

Ylli Manjani – Përshëndetje!

Sigurisht, edhe për mua është kënaqësi që jam sot për herë të parë në këtë komision si ministër i Drejtësisë. Ju më uruat suksese, por unë them që të gjithë bashkë i kemi këto suksese, sepse sfidat i kemi të përbashkëta.

Tani po i kthehem temës së ditës. Ju sapo morët një vendim, cili është shumë i rëndësishëm për këtë proces. Unë si ministër i Drejtësisë marr përsipër që së bashku me stafin e ministrisë dhe të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të jemi prezent në këto debate. Jo se ne nuk i kemi bërë këto debate, por gjithmonë është mirë që parlamenti të ketë një proces edhe më të mirë, edhe më të hapur, edhe më të garantuar, sepse, me thënë të vërtetën, kjo është një temë shumë e rëndësishme, është një temë fundamentale që trajton njëkohësisht një interes publik madhor, që është interesi ynë i përbashkët për të parë ndonjë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, i cili fillon nga reforma e pronave, të jemi realistë, por prek, gjithashtu, në të njëjtën vlerë nga pikëpamja e trajtimit edhe interesa private, personale, interesa të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, të cilat duhen trajtuar dhe duhen vendosur në një harmoni më të mirë. Nga kjo pikëpamje ne themi se ky proces që ju po ndërmerrni do të kontribuojë për mirë dhe asgjë të keqe nuk ka.

Tani po them disa fjalë për projektligjin.

Sigurisht, ju e njihni situatën aktuale të kthimit dhe kompensimit të pronave, që është një situatë që fillon që nga ligji nr.7501 e me radhë, janë bërë 7501 herë deklarata publike, i kemi bërë të gjithë së bashku, kush më pak e kush më shumë, për historitë e kthimit dhe kompensimit të pronave. Pa diskutim, më lejoni të vlerësoj të gjitha përpjekjet e derisotme të të gjitha qeverive shqiptare për të pasur një qasje sa më pozitive drejt procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, por të them të vërtetën me të gjitha këto përpjekje situata mbetet ende shumë kritike. Nëse do të vazhdojmë me këtë ritëm dhe me këtë bazë legale që kemi, e para, nuk është e sigurt që do të garantohet e drejta e kthimit dhe kompensimit të pronës sipas kriterëve të sotme ligjore, e dyta, do të na duhej një proces i gjatë, i barasvlefshëm me 4 mijë

vite, se me 1600 hektarë në vit që kompensojmë ne, shumëzohet me nevojat që janë, aq del, del edhe një herë sa historia e Beratit. Kjo është një histori që nuk mbaron këtu, ndaj qeveria ka vendosur ta trajtojë këtë problem siç duhet. Nuk insistojmë që detyrimisht kjo është formula më e mirë, por këtë kemi gjetur deri më sot si më të mirën, më realen. Le ta trajtojmë kështu për të mos qenë, le të themi, fanatikë detyrimisht në një formulë apo në një tjetër, sepse presim edhe procesin e hapur që do të bëjë ky komision, por le të vendosim disa rregulla në këtë debat. Ne duhet ta mbrojmë këtë draft, sepse mendojmë që është më i miri. Jemi të hapur nëse duhet të korrektojmë gjëra, por ne mendojmë që thelbi i këtij drafti, formula reale e kompensimit, e theksoj e kompensimit fizik dhe financiar është kjo.

Këtu ka një problem Duhet të jem i sigurtë me komisionin edhe për të ngritur nivelin e këtij debati në një nivel kushtetues.

Të nderuar deputetë, këtu përplasen dy parime kushtetuese. Parimi i parë ka të bëjë me sigurinë juridike të së drejtës të dhënë me ligj. Ky është parim kushtetues shumë i rëndësishëm, pa diskutim, por nga ana tjetër kemi edhe një parim që ka të bëjë me efikasitetin e së drejtës së dhënë. E themë më thjeshtë, nëse një e drejtë është e dhënë me ligj dhe është e sigurt që nuk zbatohet, atëherë kjo ka vlerë zero. Duhet t'i vëmë në balancë të dyja këto parime për të arritur në një konkluzion të arsyeshëm. Kemi dy rrugë: ose të mbajmë kriteret e sotme, që janë një listë dëshirash, që pa as më të voglin diskutim, unë jua them me bindje që qeveria nuk është se do të heqë dorë nga standardet e ligjit të sotëm për sa u takon dëshirave politike, por realisht nuk garantohej asgjë, realisht kthimi dhe kompensimi i pronave nuk garantohej. Do të katandisemi që të kemi vetëm një tufë me rregulla në ligjet e shkruara dhe një bashkësi pronarësh të ligjshëm, që do të vazhdojnë të rrinë me letra nën shtetull për të shkruar sa në një zyrë në tjetrën, për t'u katandisur sa në një zë buxhetor në një tjetër dhe për të pritur radhën, që nuk dihet se kur vjen. Kjo është situata.

Nga ana tjetër, le të mendojmë një skemë realiste, këtë bën ky ligj. I gjithë procesi i kompensimit konsiderohet si vlerë, si vlerë e cila futet në një formulë të re llogaritjeje. Kjo formulë ka tri komponentë: e para, merr parasysh çastin e shpronësimit, pra çfarë ka qenë prona në çastin e shpronësimit, kjo nuk është për efekt çmimi, por është për efekt kategorizimi, për të kuptuar se çfarë është, është tokë bujqësore, është tokë truall, banesë, ku është dhe çfarë vlerë eventualisht mund të marrë në procesin e llogaritjes.

E dyta, kjo futet në kriterin e dytë që ka të bëjë me vlerën e shtuar të pronës në vite, sepse ajo pronë nuk është më sot tokë bujqësore, por është tokë truall, por ka një vlerë të shtuar e nuk mund të mohohet kjo gjë.

Kriteri i tretë mbetet kriteri i referencës të harta e vlerës. Ky është kriter që e përdorim sot për të shpronësuar, sot e gjithë ditën këtë punë bëjmë. Shteti shqiptar kur i merr dikujt pronën përdor hartën e vlerës, që është një hartë që llogaritet vit pas viti për t'iu përshtatur çmimeve të tregut. Marrim dhe referojmë edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese deri më sot. Në asnjë rast nuk është folur për shpërblim të plotë. Është folur për kompensim, është folur për vlerësim të drejtë. Edhe një herë, unë nuk mbetem përkrahës i pikëpamjes që duhet të sulmojmë patjetër parimin e sigurisë juridike. Jo, siguria juridike është gjëja më e shtrenjtë që mund të ketë një shtet. Por ju lutem ta vendosim parimin e sigurisë juridike në një kontekst real. A është e sigurt një e drejtë kushtetuese, një liri kushtetuese që nuk zbatohet? Çfarë duam të sigurojmë? Duam të sigurojmë një të drejtë që nuk zbatohet. Këtu problemi nuk është politik. Unë besoj që ne nuk kemi ndarje politike në trajtimin e çështjes. Ne kemi ndarje në kuptimin parimor për të gjetur një balancë ndërmjet këtyre dy parimeve. Kemi pyetur edhe ekspertë, edhe njerëz e funksionarë që punojnë pranë gjykatave Kushtetuese këtu dhe jashtë Shqipërisë, të jemi realistë, nuk ka një mendim unik, nuk ka një mendim determinant, por jemi përpara një realiteti. E vërteta është se ne duhet të merremi vesh me 26% të aplikuesve që kemi sot në sistem, jo me të tjerët, që janë shumë më pak se 1% e popullsisë, ne duhet të gjejmë një balancë me këta, sepse pjesa tjetër, në një mënyrë apo në një tjetër është zgjidhur. Për shkak të përpjekjeve të derisotme të qeverive shqiptare duhet ta theksoj këtë gjë, këtu nuk ka ndarje politike, pavarësisht nuancave që kërkojmë t'i japim ne ndonjëherë që unë jam më i mirë se tjetri etj., etj., por le të themi që kjo është situata, ndaj duhet ta trajtojmë këtë çështje mbi interesin apo deklarin e ditës politike për të arritur në një formulë bashkëveprimi eventualisht konsensusi edhe me pjesën e grupeve të interesit, ndaj unë e mbështeta që në fillim vendimin që ju morët për seancën dëgjimore me grupet e interesit.

Çfarë propozon ky ligj përveç formulës? Ne propozojmë që 26 mijë vendimet që janë sot të eventuarizuara për kompensim të realizohen në një periudhë trevjeçare vlerësimi. Pra, të kemi një raport vlerësimi që të kuptojmë ku jemi, jo se ne nuk e dimë por duhet ta shohim në frymën e këtij ligji.

Qeveria është e angazhuar në këtë pikë, sepse ka edhe angazhim politik, duhet ta pranojmë këtë gjë, por unë nuk dua të hyj në retorikën politike, më besoni, nuk është ky qëllimi i këtij prezantimi, por ka një angazhim që një fond të jetë i ngrirë për dhjetë vjetët e ardhshëm që të garantojë kompensimin sipas formulës së re që është diku te 50 miliardë lekë, i cili do të jetë në dispozicion të këtij procesi. Shifrat janë ato që janë, kushdo mund t'i bëjë krahasimet, mos më vini mua në sikletin që kush është më i miri e kush është më i keqi, thashë nuk dua ta bëj këtë, sepse nuk është kjo tema, do të kemi tema të tjera ku do të shquajmë veten se çfarë

kemi bërë më mirë e çfarë do të bëjmë më mirë. Kjo është një temë që e tejkalon debatin politik. E theksoj që kompensimi fizik mbetet, aty ku prona është e lirë, kthehet menjëherë, pra nuk heqim dorë nga kompensimi fizik. Kam vënë re që në të tilla raste ndodhin rëndom edhe keqkuptime, por kompensimi fizik ngelet.

Sigurisht, ka edhe disa risi organizative, që kanë të bëjnë me rikonceptimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me disa procedura, të cilat ndihmojnë në përshpejtimin e kompensimit të pronarëve, siç është procedura e ankandit apo siç janë disa procedura të tjera, të cilat e ndihmojnë negociatën shtet-pronar për të përshpejtuar këtë proces, të cilat janë të parashtruara në këtë projektligj.

Unë nuk doja të hyja në detaje, por doja ta bëja këtë prezantim në nivel parimor për të kuptuar situatën ku jemi dhe për të parë mundësinë si mund ta harmonizojmë përplasjen parimore, sigurinë juridike dhe efikasitetin e së drejtës së dhënë. Janë dy momente, të cilat janë pjesë e garancive të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, por na duhet të zgjedhim ndërmjet letrës, që nuk garanton gjë, dhe realitetit që garanton diçka. Jemi të hapur nëse ka ende formula që e përmirësojnë apo garantojnë këtë të drejtë të dhënë me ligj t'i diskutojmë, jemi të hapur dhe nuk ka asnjë pengesë, por qeveria shqiptare në këtë moment ka ardhur me këtë propozim.

Unë nuk dua të zgjatem më shumë, sepse e thashë, dua ta mbaj në këtë nivel diskutimin. Faleminderit!

Jam i gatshëm për të dhënë përgjigje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër, për ekspozitën e paraqitur!

Mendoj se duhet t'i adresojmë pyetje ministrit dhe ekipit të tij lidhur me përmbajtjen e projektligjit.

Zoti Mediu, të takon ty fjala edhe me zakon, edhe me kanun.

Fatmir Mediu – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe ministrin për sqarimet.

Do të adresojë disa pyetje për të kuptuar thelbin e këtij projektligji.

Pyetja e parë ka të bëjë me drejtoreshën e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave: cilat janë arsyet për mosveprimin në bazë të ligjit për shqyrtimin e kompensimit apo kthimit fizik të pronës te pronarët e ligjshëm për më shumë se tre vjet?

E dyta, ka disa vendime të Gjykatës së Strasburgut, të adresuara qeverisë shqiptare, për t'u orientuar në zgjidhjen e këtij problemi dhe sa ky ligj reflekton vendimet e Gjykatës së Strasburgut dhe orientimi që ata kanë dhënë për zgjidhjen e kësaj çështjeje bazuar mbi të

drejtën dhe jo mbi vullnetin politik për ta shqyrtuar të drejtën? E drejta është e dhënë dhe nuk ngelet që politika ta shqyrtojë sipas interesit të vet siç ka bërë deri tani.

Sa është respektuar Kushtetuta në këtë ligj dhe në mënyrë të veçantë neni 41 i saj, që përcakton konceptin e të drejtës mbi pronën, përfitimit dhe tjetërsimit të saj?

Sa është konsultuar ky ligj me grupet e interesit? A kanë qenë ato pjesëmarrëse në debatet dhe diskutimet që janë bërë rreth kësaj çështjeje, siç është kërkuar edhe nga Gjykata e Strasburgut apo edhe nga raportet e Bashkimit European që të bëhet në transparencë të plotë dhe në diskutime me grupet e interesit, pra me shoqatat e pronarëve të ligjshëm?

Sa është sasia e fondit të kthimit fizik? Ju keni bërë një projektligj dhe duhet të dini sa është kërkesa dhe sa është fondi i mundshëm. Sa është sasia e fondit të kompensimit fizik? Do të dal te pyetja logjike, ky 500 milionë dollarëshi që keni parashikuar në 10 vjet, sa plotëson si diferencë mbas kthimit apo kompensimit fizik nevojat dhe kërkesat e pronarëve?

Si është përcaktuar kjo faturë financiare, mbi ç'kriter?

Flisni për vlerë në kohën e shpronësimit dhe nga shpjegimet që u dhanë u tha se u bë për shkak të kategorizimit të pronës tokë bujqësore apo tokë truall etj., duke vlerësuar edhe kontributet apo tjetërsimin e kësaj prone në 45 vjet, 65 vjet apo u bën 70 vjet. Këtë e njihni si atribut dhe vlerë të shtetit apo si një e drejtë e mohuar pronarit, i cili mund ta kishte tjetërsuar po ashtu dhe mund t'i kishte përfituar të mirat që siguron prona?

Zoti Ministër, pyetjen e fundit e kam për ju. E dëgjova diskutimin tuaj dhe flisni për një të drejtë në letër që është e pazbatueshme. Nuk e di kush e ka tagrin qoftë në politikë, qoftë në ekzekutiv, qoftë në shoqëri që të diskutojë vlerën e një të drejte. Unë di që të drejtat janë të detyruara për t'u zbatuar, ashtu siç janë shkruar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Ministër, keni fjalën.

Ylli Manjani – Faleminderit, zoti Mediu!

Unë po i përgjigjem pyetjes që më bëtë mua, sepse më intrigon, për hir të së vërtetës, se kush e vlerëson respektimin e një të drejte. Sigurisht, është parlamenti ai që vlerëson sa një e drejtë e dhënë me ligj është respektuar ose jo. Në një republikë parlamentare, parlamenti ka kontroll të plotë jo vetëm mbi ligjbërjen, por edhe mbi ligjzbatimin. Ka të drejtë t'i kërkojë llogari qeverisë pa asnjë hezitim për ligjzbatimin.

Kur unë prezantova faktin e pamundësisë, e prezantova për shkak të një pamundësie reale që ekziston. Kjo nuk do të thotë që ky është një vendim që ne e kemi marrë. Jo. Po e pozojmë këtu në parlament që të ndihmojmë parlamentin, vendimmarrësit e këtij shteti për të arritur në një zgjidhje të arsyeshme. Duke qenë koshient, unë vetë e pozova problemin, për të

treguar që kemi një përplasje me parimin e sigurisë juridike. Të jemi realistë. Në këtë pikë ajo që thashë është më se e vërtetë dhe nuk e kam thënë vetëm unë, por ky është një fakt që ekziston. Ne mund ta ruajmë ligjin siç e kemi sot, e zgjasim afatin, meqë ka rënë nga fuqia, por nuk e garantojmë, ose e garantojmë në 4000 vjet. Pra, duket një histori e pamundur. Në këtë pikëpamje po përpiqem të prezantoj edhe diskutimin e parimeve kushtetuese, por edhe realitetin ku këto parime zbatohen. Ky është problemi.

Për çështjet konkrete drejtoresha është më kompetente sesa unë. Ju kërkoj ndjesë për këtë pjesë.

Sonila Qato – Faleminderit!

Unë po i marr me radhë pyetjet e drejtuara nga zoti Mediu. Pyetjen e parë se cila ka qenë arsyeja për mosveprim i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave gjatë këtyre dy vjet e ca veprimtari nga tetori i vitit 2013 e deri më sot dua ta lidh me pyetjen e dytë se sa janë reflektuar vendimet e Gjykatës së Strasburgut në projektligjin e paraqitur nga ana e qeverisë në këtë komision.

Duhet t'ju them që në krye herës se baza mbi të cilën është punuar materiali dhe hartimi i draftit, i cili sot paraqitet në komision, ka qenë vendimi pilot i Gjykatës së Strasburgut për Manushaqe Puto e të tjerë kundër shtetit shqiptar. Në këtë vendim pilot të korrikut të vitit 2012 Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka kërkuar shtetit shqiptar dhe qeverisë së asaj kohë marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për të zgjidhur këtë situatë, këtë ngërç që ishte krijuar për shkak të një mosveprimi normal dhe të tejzgjatur të legjislacionit në fuqi për kthimin dhe kompensimin e pronave. Këtu flitet për një legjislacion, i cili ka filluar të nisë hapat e parë të veprimtarisë së tij që në vitin 1993. Në vitin 2012 Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut u detyrua për shkak të fluksit të madh të ankesave të drejtuar nga pronarët pranë kësaj gjykate, marrjen e një vendimi pilot, të cilin nuk është se e ka praktikë rutinë të punës së saj. Vetë vendimi pilot i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut pezulloi shqyrtimin për 18 muaj të ankesave apo padive të paraqitura në këtë gjykatë vetëm me kushtin që qeveria shqiptare në atë kohë të merrte masa reale dhe efektive për zgjidhjen e këtij problemi.

Vendimi pilot i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar në përmbajtjen e tij rreth 115 pika, të cilat për shtetin shqiptar dhe për qeverinë shqiptare janë rekomandime dhe masa të cilat ajo ia ka obliguar shtetit shqiptar për të marrë e për të kthyer përgjigje. Një nga parashikimet e bëra është edhe fakti që deri më tani, pra, sipas legjislacionit në fuqi në vitin 2012 shteti shqiptar nuk kishte garantuar një trajtim të barabartë të pronarëve

nëpërmjet procesit të nisur, bazuar në ligjet në fuqi të vitit 2004. Kjo kryesisht në respektim të së drejtës së pronarëve për t'u kompensuar.

Në fakt, të dhënat e rezultuara në vitin 2013 nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave e vërtetuan më së miri këtë fakt të konkluduar nga gjykata, duke thënë se nga 26 mijë vendime, të cilat nuk ishin numëruar asnjëherë deri në vitin 2013, rezultoi që vetëm 16 hektarë tokë ishin arritur të kompensoheshin nga qeveria shqiptare nga viti 2005 deri në vitin 2015, në të kundërt 73 mijë hektarë tokë, e cila pritej nga ana e pronarëve të kompensohej nga ana e shtetit shqiptar. Pra, konkludua që ishim në një situatë, për të cilën nuk mundëm të mbyllnim veshët dhe të vazhdonim të zbatonim një ligj, i cili nuk ishte efektiv, nuk siguronte mjete të sigurta për të garantuar të drejtat e pronarëve dhe mund të ishim ende në shkelje të parimeve të së drejtës dhe të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky ka qenë një vendim i marrë nga ana jonë me objektivin për të filluar zbatimin e një plani veprimi konkret që qeveria shqiptare e ka miratuar në muajin prill të viti 2014, ku ka përcaktuar hapa konkretë të planit të punës dhe të veprimtarisë së Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila ka filluar me inventarizimin e të gjithë vendimmarrjes së kthimit dhe kompensimit të pronave. Kjo ka qenë një punë kolosale, që ka marrë kohën e vet fizike në agjenci, nga viti 1993 deri më sot, janë regjistruar të gjitha vendimet administrative të dhëna sipas rekomandimeve të Gjykatës së Strasburgut të dhëna nga viti 1993 deri më sot në një regjistër elektronik, që është publik dhe i aksesueshëm për të gjithë qytetarët, duke bërë edhe transparencën për herë të parë në këtë proces, duke bërë llogaritje se sa prej këtyre vendimeve kishin detyrime që shteti shqiptar të kompensojë pronarët, të cilët janë zvarritur në këtë proces 23-vjeçar, cila do të ishte kjo vlerë dhe çfarë mjedesh efektive të brendshme qeveria do të identifikonte për të zgjidhur këtë situatë dhe problematikë të gangrenizuar më të cilën u përball. Ndaj projektligji i paraqitur nga ana e qeverisë është një projektligj që jo vetëm zbaton direktivat apo rekomandimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në përmbajtjen e saj, por edhe është bazuar në doktrinën e krijuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese në të gjitha vendimet e dhëna nga kjo gjykatë gjatë shqyrtimit të çështjeve që kanë lidhje me fushën e kthimit dhe kompensimit të pronave.

Në lidhje me pyetjen e tretë se si është rregulluar në këtë ligj zbatimi i Kushtetutës, pra sa është në përputhje me Kushtetutën ky projektligj, ju siguroj që në të gjitha konsultimet që kemi bërë, edhe me ekspertë të fushës së të drejtës, civilistë apo kushtetucionalistë, të cilët kanë njohuri të thella në këtë fushë, sidomos në fushën e të drejtës së pronësisë, ne kemi marrë mendimet dhe orientimet nga ana e tyre sikurse kemi reflektuar të gjithë doktrinën e krijuar nga Gjykata Kushtetuese në raport me kthimin dhe kompensimin e pronave. Për detaje më të

thella në raport me këtë aspekt dhe me këtë pyetje, në një seancë pyetjesh, duke e përgatitur këtë pyetje më gjerësisht, mund të japim shpjegime më teknike.

Në lidhje me pyetjen e katërt, sa është konsultuar ky ligj me grupet e interesit, ju bëj me dije se Ministria e Drejtësisë së bashku me institucionet e saj të varësisë, Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Avokaturën e Shtetit ka organizuar disa tryeza konsultimi publik me të gjitha grupet e interesit dhe të gjitha institucionet bashkërenduese në këtë aktivitet. Nga muaji tetor i vitit 2014 janë kryer dy tryeza, janë bërë edhe dy tryeza të tjera me grupet e interesit në korrik të vitit 2015, është bërë lancimi publik nga ana e qeverisë. Projektligji ka qenë i shpallur publikisht në të gjitha faqet zyrtare të institucioneve të Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ku janë hapur edhe adresa elektronike, ku të gjithë të interesuarit mund të bënin sugjerimet e tyre në bazë të materialit të shkruar e të publikuar në këto faqe dhe në konkluzion mund të përmbledh faktin që janë kryer pesë tryeza konsultimi publik me grupet e interesit, përsos takimeve të njëpasnjëshme që unë si titullar i këtij institucioni kam kryer me secilin prej përfaqësuesve të shoqatave që kanë rol në fushën e pronave.

Për sa i përket pyetjes se sa është evidentuar fondi fizik dhe sa është fondi i kompensimit financiar, duhet të përmendim një fakt që është shumë i rëndësishëm dhe ka orientuar edhe hartimin e këtij draftprojektligji. Ky draftprojektligj shoqërohet edhe me një studim të hollësishëm në raport se sa ka mundësi shteti shqiptar për të përballuar faturën e kompensimit që do të rrjedhë nga ky proces, faturën e konkluduar deri më sot për shkak të 26 mijë vendimeve që kemi regjistruar, të cilat presin të kompensohen për herë të parë, pra nuk janë kompensuar asnjëherë deri më sot, dhe atë çfarë do të derivojë nga shqyrtimi i rreth 10500 apo 11000 dosjeve, të cilat sot në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave presin që të merren në shqyrtim.

Dua të theksoj faktin që për herë të parë në funksion të kompensimit të pronarëve, qeveria vendos një shumë financiare për kompensimin e pronarëve në vlerën e 50 miliardë lekëve, e cila praktikisht është dhjetëfish apo dhjetë herë më shumë se ajo që është vendosur gjatë periudhës 2005-2015 në funksion të pronarëve, ndërkohë që ky projektligj krijon fondin e kompensimit të pronarëve, një fond i paprekshëm ky i përbërë nga fondi financiar dhe nga fondi i tokës, që ka një përbërje fondi fizik pronash me një status të pasur juridik shtet. Aktualisht, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka në disponim të saj fondin e tokave bujqësore prej 23 mijë hektarësh, që në një vlerë ekonomike vlerësohet 33 miliardë lekë, ka fondin pyjor e kullësor i vendosur në dispozicion të kësaj agjencie me një VKM të vitit 2008, me një vlerë të përlogaritur në masën e përafërt rreth 50 miliardë lekësh, ka edhe

fondin e objekteve, fond i cili deri vonë nga Ministria e Ekonomisë, për shkak të atyre objekteve, të cilat dëshmojnë ankandet e kryera sipas procedurave që kryen kjo ministri në një vlerë prej 2,4 miliardë lekësh, ndërkohë që në funksion të përmbushjes së misionit që merr përsipër ky projektligj, është përcaktuar edhe ngritja e një komisioni ndërinstitutional me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili ka për detyrë që herë pas herë të krijojë dhe pasurojë fondin fizik për pronarët me pasuri shtet-pronë të paluajtshme derisa ky mision të përmbushet me sukses sipas angazhimit të marrë në një periudhë kohore dhjetëvjeçare.

Për sa i përket formulës që parashikon ky projektligj, e cila ka lidhje me momentin e shpronësimit...

Fatmir Xhafaj – Më falni, ministri kërkon mirëkuptimin tuaj për t'u larguar se i duhet të shkojë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Faleminderit, zoti Ministër! Mirë u takofshim përsëri!

Sonila Qato – Formula që paraqet ky projektligj është një formulë e cila arrin të realizojë një mënyrë të trajtimit të barabartë të pronarëve, e cila mbështetet në dy shtylla kryesore, të cilat trajtojnë të gjitha vendimet që presin për t'u trajtuar apo vendime që tashmë janë përfundimtare dhe presin që të kompensohen apo t'i nënshtrohen këtij projektligji.

Zgjidhja që kemi bërë për zërin kadastral të tokës në momentin e shpronësimit ka qenë një zgjidhje, e cila e bën real e të prekshëm formulën që do të aplikohet nëpërmjet këtij projektligji për kompensimin e pronarëve apo për procesin e trajtimit të dosjeve ende pa vendimmarrje në agjenci.

Sigurisht që momenti i shpronësimit është një moment që do t'i nënshtrohen të gjithë pronarët, jo vetëm një kategori e përcaktuar e tyre. Pra, në këtë sistem do të hyjë i gjithë procesi i cili është nisur në vitin 1993 dhe do të përfundojë me mbylljen e afatit të këtij projektligji.

Vetëm duke zbatuar kritere të barabarta për të gjithë pronarët, do të mund të plotësojmë ato rekomandime që na janë dhënë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ristani, urdhëroni për të bërë pyetje.

Ju lutem, bëni vetëm pyetje pa diskutime, sepse do të kemi edhe seancën e diskutimit.

Arben Ristani - Nga fondi i tokave që janë mbajtur për të kompensuar ish-pronarët, gjatë këtyre dy vjetve sa hektarë keni hequr nga ky fond dhe përse?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ristani!

Zonja Qato.

Sonila Qato – Kemi trashëguar, sikurse e përmenda edhe më përpara, në vitin 2013 një fond objektesh të vlerës 2,4 miliardë lekë, fondin e tokës bujqësore përmes një VKM-je të

vitit 2008 prej 18 mijë hektarësh dhe fondin pyjor e kullësor, edhe kjo me një VKM të vitit 2008 prej 71 mijë hektarësh tokë fond pyjor e kullësor. Ajo çfarë ne u përballëm me këtë situatë, me këtë fond fizik të trashëguar ishte fakti që agjencia nuk kishte asnjë informacion teknik, hartografik apo të statusit juridik të këtyre pronave, se ku ishin të pozicionuar këto prona, çfarë vlere do të kishin sipas hartës së vlerës së pronave në fuqi dhe sesi mund të shpërndareshin këto prona në qoftë se nuk do të kishim një informacion në lidhje me to për t'u trajtuar si fonde për kompensimin e pronarëve. Ndërkohë në muajin nëntor të vitit 2014, me një vendim të qeverisë është hequr fondi i tokës bujqësore 18 mijë hektarë, duke u zëvendësuar me të njëjtin vendim qeverie, me një fond të tokës bujqësore prej 23 mijë hektarësh në dispozicion të kompensimit të pronarëve.

Fondi prej 23 mijë hektarësh vënë në dispozicion përmes vendimit të qeverisë së vitit 2014 për herë të parë ka qenë një fond i identifikuar me statusin juridik të verifikuar pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe me një vlerë ekonomie bazuar në hartën e vlerës së pronës. Ky do të jetë fondi me të cilin ne do të fillojmë menjëherë nga puna nëse ky projektligj do të hyjë në fuqi.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – E kuptova që ka pasur një fond 18 dhe është bërë 23, por nuk arrita të kuptoja përgjigjen. Po bëj një pyetje më të saktë: sa mijëra hektarë fond toke kompensimi në zonën e Bufit të Sarandës, që ka qenë fond kompensimi, ashtu i quan zona, tokat e Bufit, janë hequr nga fondi i kompensimit? Dini gjë?

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Qato.

Sonila Qato – Zoti Ristani, për të mos përsëritur edhe një herë të njëjtën fjalë, agjencia nuk ka trashëguar asnjë material hartografik dhe teknik për pozicionimin e sipërfaqes 18 mijë hektarë që qeveria ua ka akorduar pronarëve dhe ia ka vënë në dispozicion kësaj agjencie për procesin e kompensimit fizik. Unë nuk jam në gjendje të them ku kanë qenë të pozicionuar 18 hektarët e vënë nga qeveria në vitin 2008 për arsye se pranë kësaj agjencie nuk ka pasur asnjëherë informacion zyrtar se ku është pozicionuar ky fond. Duke qenë i tillë, nuk ka pasur mundësi kjo agjenci që të shpërndajë fondin fizik në funksion të pronarëve. Këtu shtoj edhe një fakt që aktet nënligjore në fuqi të ligjit nr.9235 për kthimin dhe kompensimin e pronave, nuk kanë të përcaktuar asnjë procedurë konkrete, transparente dhe reale për ndarjen e fondit fizik për kompensimin e pronarëve. Si i tillë ky fond prej 18 mijë hektarësh ka qenë një fond fantazmë, që u akordua në funksion të pronarëve, por nuk u arrit dot që nga viti 2008 deri në vitin 2013 t'u shpërndahej ndonjë metër katror pronarëve në funksion të destinacionit që ai fond kishte.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Qato!

Zoti Bylykbashi, keni fjalën.

Do t'ju lutesha të bënim një proces normal, ka një votim në fund. Kush dëshiron ta ndjekë procesin, le ta ndjekë, kush nuk dëshiron, le të mos e ndjekë, Ju lutem mos bëni komente kur bëni pyetje.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë do t'i bëj pyetjet një pas një.

Zoti ministër, i cili nuk është këtu, tha që jemi përballë çështjes së sigurisë juridike, parim kushtetues, dhe efikasitetit të së drejtës së njohur. Tha që efikasiteti i të drejtës së njohur po zhbën sigurinë juridike. Unë besoj se ato janë komplementare dhe jo përballë.

Do t'i kthehem pyetjes që bëri zoti Mediu. Për cilën arsye, të bazuar në ligjin shqiptar, sepse jam i sigurt që nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Europiane që ndalon zbatimin e ligjit shqiptar, është bllokuar për 2 vjet zbatimi i ligjit që është sot në fuqi? Cili është ai akt ligjor, që ka bllokuar zbatimin, që do të thotë: marrjen, trajtimin e dosjeve përkatëse, njohjen e pronës, kthimin kur është e lirë, kompensimin kur nuk është i mundur, të pronave nga momenti kur ju, zonja drejtoreshë, morët detyrën dhe deri më sot? Ju nuk jeni organ politikbërës, ju jeni organ ligjzbatues. Është shumë e rëndësishme, sepse ka bërë një premtim këtu me pyetjen që i kam bërë unë.

Fatmir Xhafaj – Të përgjigjet ajo dhe në qoftë se nuk je i qartë, bëjini pyetje tjetër.

Oerd Bylykbashi – Në këtë komision i kam kërkuar drejtoreshës nëse do të do të pezullohej zbatimi i ligjit dhe ka premtuar para komisionit: jo! Tani, cili është akti ligjor apo çdo lloj akti tjetër, me të cilin ju keni pezulluar dhe a mendoni që kjo ka cenuar të drejta pronarësh gjatë këtij 2-vjeçari, të paktën të dosjeve të hapura në kohën kur ju keni marrë detyrën?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Qato!

Sonila Qato – Nuk dëshiroj të përsërisë të njëjtën përgjigje që të njëjtës pyetje i ktheva përgjigje, zotit Mediu. Por premtimi, që kam dhënë në këtë komision një vit më përpara, ka qenë një premtim, i cili është mbajtur nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Ai ka lidhje me të gjithë procesin që kjo Agjenci në këto 2 vjet punë, ka arritur të realizojë në strukturat e saj, me objektiv kryesor realizmin e një reforme reale dhe të qenësishme, siç është prezantimi i këtij projektligji në Agjenci.

Të nderuar deputetë,

Në vitin 2013 në Agjencinë e Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ishte një numër i pidentifikuar dosjesh për shqyrtim, të cilat asnjë institucion zyrtar dhe jo më agjencia nuk

ishin në gjendje të thoshte sa aplikime pa vendimmarrje ndodheshin të trashëguara prej vitesh, dhe datojnë nga viti 1993, pa vendim në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Së dyti, u njohëm me fenomenin që dosjet nxirreshin nga arkiva me iniciativë të drejtorit të Përgjithshëm. Kjo do të thotë se Drejtori i Përgjithshëm, i asaj kohe, kur kishte dëshirë nxirrte dosje për shqyrtim dhe kur nuk kishte dëshirë nuk i nxirrte këto dosje. Nga kjo rezultojë se 4 mijë dosje ishin të shpërndara në 4 sektorët e shqyrtimit në këtë agjenci dhe rreth 5 mijë dosje ishin të plurosur në pseudoarkivën e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të cilat nuk kishin shansin ndonjëherë të merreshin në shqyrtim. Këto ishin konstatimet që ka bërë edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në rekomandimet e saj, duke përmendur faktin që pronarët nuk janë duke u trajtuar në mënyrë të barabartë nëpërmjet legjislacionit që është në fuqi, dhe mekanizmave që ka përcaktuar ky legjislacion.

Nuk të merrnim vendime gjatë këtyre 2 vjetve në qoftë se nuk do të merrnim parasysh faktin se sa kanë qenë pretendimet në total të pronarëve, të cilët presin t'u njihet pronësia, të kompensohen apo të kthehen, ashtu sikurse pa bërë një analizë të mënyrës sesi do të procedohej, për faktin se ishin në pamundësi të zbatimit të këtij ligji, për shkak të një detyrimi shumë të madh që ky ligj mbante përsipër përpara qytetarëve, nëpërmjet ekzistencës së tij, dhe një pamjaftueshmërie që shteti kishte për ta realizuar këtë të drejtë që parashikonte ky projektligj.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Atëherë, unë nuk është se kam qejf të bëj pyetje për të sqaruar pyetjen e parë. Ju kërkoja aktin me të cilin është marrë vendimi për pezullimin e zbatimit të ligjit, që ka sjellë për pasojë mos shqyrtimin e një numri iks dosjesh, mund të na e thoni ju, që ju i gjetët të hapura në proces trajtimi? Ka mundësi, zoti Fino! Zoti Fino, kur të flisni ju, unë do t'ju dëgjoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, mos bëni komente, bëni vetëm pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Cili është vendimi juaj, urdhri juaj dhe kur është marrë? Cili është vendimi i qeverisë, me të cilin është urdhëruar ndalimi i zbatimit të ligjit? Cili është ligji me të cilin është pezulluar zbatimi i këtij ligji? Cili është vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që ka pezulluar zbatimin e këtij ligji apo e ka shfuqizuar atë, atë që është sot në fuqi, apo vendimi i Gjykatës Europiane, i cili ka çuar për pasojë mos shqyrtimin e vendimeve ekzistuese, ato që keni gjetur ju, dhe besoj të disa qindra vendimeve, që nëse ju me rutinën minimale të punës do të kishit bërë deri më sot këtë ligj të keq?

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, përgjigjuni në mënyrën si e çmoni, vlerësimin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sonila Qato – I njëjti akt, i cili ka pezulluar shqyrtimin...

Fatmir Xhafaj – Qetësohuni se pronat ka 25 vjet që po i sillni vërdallë në këtë vend. Bëni si heronj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sonila Qato – Është pezulluar veprimtaria e vendimmarrjes në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me të njëjtin “akt”, i cili ka pezulluar këtë veprimtari për 8 vjetët e fundit të qeverisjes së kaluar, ku në një vit janë dhënë mesatarisht 1000 vendime nga 7000, 8000, sipas dëshirës ishte numri i dosjes, sepse nuk ka qenë asnjëherë i identifikuar pa vendimmarrje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I njëjti “akt” që ka mbajtur pezull vendimmarrjen e përealizuar nga qeveria e kaluar në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, i njëjti “akt” ka mbajtur pezull, por kësaj radhe me një mision shumë të qartë, për të dhënë një zgjidhje konkrete, reale, të thjeshtë dhe të realizueshme nga ana e qeverisë për procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave.

Nga krahu tjetër, nuk gjykoj se këtu është nevoja për të pasur një akt konkret për të pezulluar këtë vendimmarrje, për shkak se Agjencia ka qenë në intensitet të plotë pune për të bërë hartën dixhitale të pronave. E para iniciativë në 23 vjet, e cila është duke u realizuar ndërkohë nga kjo agjenci, e cila do të bëjë dhe zbardhjen, edhe transparencën një herë e mirë të këtij procesi shumë të gjatë, ku fakti që janë mbajtur në errësirë të plotë ka sjellë vetëm korrupsion dhe abuzim në lidhje me pronat shtet apo me pronat e pronarëve, sipas rastit në këtë vend.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Zonja drejtoreshë, sapo më thatë që në 2 vjet, duhet të ishin marrë rreth 2000 vendime nga Agjencia, në mënyrën edhe më të keqe të mundshme, por 2000 vendime duhet të ishin marrë.

Tani, ju keni parasysh që Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka kritikuar ndryshimet e shpeshta të ligjit, që ne besoj jemi përpjekur, në gjithë këto vite, ta bëjmë për të përmirësuar procesin, të gjithë ne. Këtë e ka konsideruar si diçka që cenon të drejtën e pronësisë. Tani, ju, përveçse pa asnjë një akt, e pranuat vetë, që nuk keni bërë gjë në 2 vjet, sepse keni menduar diçka më të madhe, tani po sillni një ndryshim themelor të ligjit. Si e çmoni ju këtë, në dritën e jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, në lidhje me cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike? Vetë ministri tha që jemi përpara një dileme, ku një nga

krahët e dilemës është siguria juridike, sepse kemi njerëz, të cilët kanë fituar të drejta me ligj, kanë fituar pritshmëri ligjore dhe ju po ktheheni në '93-shin thatë, ndërkohë që, në fakt, qëllimi i ligjit është të kthehet më 29 nëntor 1944, po të lexoni vendimin e Gjykatës Kushtetuese këtë thotë. Thotë: “Shteti kuptoi që kishte shkelur një të drejtë rëndë dhe po vetë shpronësohet për të rivënë të drejtën në vend”. Pra, nuk merr parasysh Gjykata Kushtetuese interesin e shtetit, por interesin e individëve pronarë. Tani, ju si e shikoni këtë raport, sa e cenon të drejtën e fituar të individëve pronar, jo të shoqërisë, të atyre kanë fituar pronë, të atyre që janë gati për ta fituar pronën, apo duhet të kompensohen? Si e shikoni ju këtë situatë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Qato.

Sonila Qato – Kam vetëm një paragraf të vendimit nr. 9, datë 26.02. 2007 të Gjykatës Kushtetuese se në fushën e kompensimit dhe kthimit të pronave e cila thekson, “Ka të bëjë me bindjen individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme”.

Projektligji në këtë aspekt garanton parimin e sigurisë juridike garanton për sa u përket të gjitha pronave të njohura, të kthyer apo të vendosura për kompensim deri më sot, pasi asnjë cenim nuk do të pësojnë vendimmarrjet e deritanishme. Objektivi që merr përsipër ky projektligj është trajtimi i barabartë i të gjithë pronarëve, përmes aplikimit të një skemë të re, e cila do të realizojë në masën 100%, përfundimin e procesit të nisur prej 23 vjetësh. Çka do të thotë që përkeqësimi i gjendjes së krijuar pronarëve në këto 23 vjet proces, nëpërmjet akteve të mëparshme, duke filluar nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave deri te vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk mund të lihen të tilla, duke u bazuar vetëm në parimin e sigurisë juridike, nëse ato nuk janë të zbatueshme dhe përkeqësojnë gjendjen e qytetarit apo të pronarit në rastin konkret.

Në këtë projektligj, përveç parimit të sigurisë juridike, është përdorur dhe parimi i drejtësisë dhe i proporcionalitetit, ku Gjykata Kushtetuese ka vendosur edhe fjalën e saj në këtë aspekt: Parimi i rregullimit të drejtë dhe i shpërblimit të drejtë, barazinë juridike, transparencën, të drejtën e informimit, luftën kundër korrupsionit dhe paanësinë dhe, mbi të gjitha, parimin e interesit publik.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se një nga kriteret kushtetuese, që gjen zbatim në dispozitat e kthimit dhe të kompensimit të pronave, është interesi publik. Marrja e pronës, në bazë të një politike të llogaritur për të arritur drejtësinë shoqërore brenda komunitetit, mund të përshkruhet saktësisht si politikë në interes publik. Unë mendoj se jemi duke folur në këtë

fushë. Prandaj i njihet e drejta ligjvënësit që për arsye të ekzistencës së interesit publik, mund të kufizojë hapësirën e disponimit të pronës private, me qëllim që një ndërhyrje e tillë ndaj së drejtës së pronës të jetë e justifikuar. Është e domosdoshme që të ekzistojë dhe një marrëdhënie përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura edhe synimit. Në këtë aspekt Gjykata Kushtetuese ka shumë përcaktime dhe parashikime, të cilat janë në vijën e logjikës që ky projektligj përdor për të arritur objektivin e përfundimit të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave brenda një afati të arsyeshëm, sipas kërkesave të bëra edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni pyetje tjetër?

Oerd Bylykbashi – Sigurisht!

Ju na cituat dhe vendosët interesin publik mbi të drejtën e pronësisë dhe sigurinë juridike që e mbron këtë drejtë pronësie, e cila është fituar ose që duhet të ishte fituar me kohë. Unë kam parasysh se interesi publik, në diskutim për pronën, kryesisht shtrohet në momentin e shpronësimit. Unë nuk besoj se ky është ligj për rishpronësim të pronarëve. Tani, një pyetje të thjeshtë, ju e keni hequr konceptin kthimit të pronës, apo jo?

Sonila Qato – Jo!

Oerd Bylykbashi – Nuk ekziston këtu i shkruar.

Në qoftë se një person ka 10 mijë metra katrorë pronë për t’u njohur, është e lirë sot, ka një vlerë iks, 1 mijë lekë metri katror, le të themi, dhe më 29 nëntor të 1944-s, kur filloi të shpronësohej pronari, vlente 10 lekë. Pra, 100 lekë sot, 10 lekë, atëherë. Ju çfarë do të bëni me këtë pronë? Ma shpjegoni thjeshtë për shqiptarët më tepër, se ne besoj se e kuptojmë: si do ta njihni kthimin, se thatë që nuk është hequr kthimi, dhe kompensimin dhe sa do të marrë ky person në fund fare, pra kthim fizik sa do të marrë ky person?

Sonila Qato – Unë ju falënderoj për këtë pyetje, sepse kjo është një pyetje shumë e rëndësishme, ka lidhje me këtë projektligj, por edhe me opinionin, i cili është krijuar ndër grupet e interesit në diskutimet që ata kanë bërë! Me fjalë të thjeshta, dua të them se projektligji i paraqitur në këtë tryezë e ruan procesin e kthimit të pronës në kuptimin siç është përdorur deri më sot nga legjislacioni në fuqi.

Termi “kthim” është zëvendësuar në projektligjin e ri me termin “kompensim fizik në pronën e njohur”. Kjo do të thotë se të gjitha kërkesat që sot janë pa u trajtuar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas projektligjit në kapitullin, që trajton këtë proces, e njeh të drejtën e Agjencisë për të realizuar procesin e njohjes së pronësisë 1, procesin e kthimit të pronës, aty ku prona është e lirë dhe procesin e kompensimit të pronës.

Pra, në qoftë se këto 10 mijë metra katrorë tokë, truall sot, pavarësisht faktit se mund të ketë qenë tokë bujqësore në vitin '45, figurojnë të lira dhe mund t'u kthehen pronarit, ato do të trajtohen si të tilla nga Agjencia dhe do të realizohet ai proces i njohjes dhe i kompensimit fizik në pronën e njohur.

Për tokën truall nuk ka kufizim. Është ruajtur një kufizim 100 hektarë për tokën bujqësore, kjo një gjë e trashëguar deri më sot edhe nga legjislacioni në fuqi, që kishte një kufizim për trajtimin e tokës bujqësore. Nëse 1 mijë hektarë apo 10 mijë hektarë janë të lira në tokën e pretenduar nga pronari dhe vërtetohet se janë pronë e tij, ato do t'i kthehen pronarit. Në qoftë se brenda kësaj sipërfaqe ka pronë për kompensim dhe në rastin tjetër, kur jemi në një pronë, e cila ka ndryshim të zërit kadastral të saj, atëherë do të implementohet formula nëpërmjet vlerësimit ekonomik që do t'i bëhet pronës dhe formulës së përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të këtij projektligji. Por ju siguroj faktin që në qoftë se prona është e lirë dhe ka mundësi t'i kthehet pronarit, ajo do t'i kthehet pronarit. Ky është një nga parashikimet që përmban kapitulli përkatës për trajtimin e kërkesave ende të pashqyrtuara në këtë projektligj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni pyetje?

Oerd Bylykbashi – Kam dhe 2 pyetje.

Tani, zoti Fino, do të ushtroni durimin, se do ta bëj unë kur të flisni ju.

(Zoti Fino, ndërhyrje pa mikron.)

Zoti Fino, do të shumë i duruar kur të flisni ju.

Fatmir Xhafaj - Edhe 2 pyetje ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Ju përsëri rikonfirmuat konceptin e shpronësimit, sepse kur dikush ka një iks pronë, do ta marrë të gjithën atë që është, dhe kompensimin të plotë për pjesën tjetër. Formula juaj po shkon drejt shpronësimit.

Nga Komiteti i Ministrave, me sa jam në dijeni, ju kërkohet që të jepni shpjegime për një seri çështjesh në lidhje me këtë projektligj. Duke qenë se ju keni marrë përsipër, si agjenci, që të hartoni të gjithë këtë plan të madh, meqë ligji po shqyrtohet sot me procedurë të përshpejtuar, cilat janë çështjet që kërkon sqarim Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës dhe çfarë shpjegimesh keni kthyer ju tani, që ligji është në shqyrtim dhe drejt rrugës së votimit në parlament?

Fatmir Xhafaj – Zoti zëvendësministër.

Idlir Peçi – Për sa u përket marrëdhënieve me Këshillin e Europës dhe me Komitetin e Ministrave, është një marrëdhënie që ka nisur mbi 2 vjet më parë, që kur ne e morëm këtë

proces. Dua të them se ka qenë shumë negative fillimisht përqasja e Këshillit të Europës dhe Komitetit të Ministrave ndaj qeverisë shqiptare me disa rezoluta dhe deklarata, të cilat ishin tejet shqetësuese për Shqipërinë.

Ne arritëm ta kthenim që në mars të vitit 2014 kursin, politikisht të paktën, me Komitetin e Ministrave, me planveprimin e paraqitur në atë kohë. Në momentin e fillimit të hartimit të ligjit ne kemi ftuar ekspertë të Këshillit të Europës dhe më saktë ekspert të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave, të cilët kanë ardhur dhe kanë asistuar agjencinë dhe Avokaturën e Shtetit në hartimin e draftit, që ju sot keni përpara, si dhe ekspertë të Bankës Botërore. Këta ekspertë kanë ardhur në Shqipëri dhe ne kemi pasur disa tryeza me ta konsultative, janë shkëmbyer mendime. Është e vërtetë, ajo që përmendi, zoti Bylykbashi, që në qershor është marrë një vendim i Komitetit të Ministrave, ku përgëzohet qeveria shqiptare për nismën që ka marrë dhe janë disa çështje, të cilat me të vërtetë kërkojnë shpjegim. Ato çështje që kërkojnë shpjegim besoj se janë këto çështje që po flasim, por ndoshta drejtoresha ka diçka për të shtuar në këtë aspekt për sa i përket teknikalliteteve.

Sonila Qato – Doja të shtoja vetëm faktin se Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në hartimin e këtij projektligji ka pasur një rol shumë të rëndësishëm për krijimin e bazës së punës për ngritjen e shtyllave të këtij projektligji, që do të thotë se nuk ka bërë politika. Ajo ka bërë fizibilitetin e gjendjes, ka bërë një studim dhe ka pajisur grupin e punës me të gjitha pyetjet që ata i kërkonin shpjegim, të cilin mund ta jepte teknikisht vetëm kjo agjenci, duke i dhënë raportet përkatëse, shifrat e nevojshme dhe të gjithë aspektin teknik, që ka nevojë një grup pune për hartimin e një politike të re në këtë fushë. Është Ministria e Drejtësisë organ i cili është politikbërës dhe ka rolin e saj shumë të rëndësishëm, së bashku me institucionet e saj të varësisë, për hartimin e projektligjit të paraqitur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetje, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë, në funksion të pyetjes, pa dashur të bëj koment, dua të citoj, edhe për kolegët, një paragraf shumë të rëndësishëm nga ajo që OSBE-ja...

Fatmir Xhafaj – Të lutem, vumë një rregull, të mos bëjmë komente!

Pandeli Majko – Jo, e kam në funksion të pyetjes!

Fatmir Xhafaj - Të gjithë në funksion të pyetjes e kanë, nuk ka njeri jashtë pyetjes.

Pandeli Majko – Nëse nuk e bëj parashtrimin pyetja nuk ka kuptim. Projektligji prezanton një skemë të re për kompensimin e ish-pronarëve, ndryshe nga praktika legjislative e mëparshme “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, që fillon me ligjin nr. 7698 të vitit ’93.

Fatmir Xhafaj - Zoti Majko, të lutem, pyetjen!

Pandeli Majko – Ky akt, me sa duket, bazohet në rekomandimit e vendimit pilot të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, si dhe ka parasysh praktikat ndërkombëtare në lidhje me kompensimin e ish- pronarëve të shpronësuar nga regjimet totalitare. Mendoj se kjo është për esencën e pyetjes që unë kam. Sa është numri i vendimeve që aktualisht qytetarët shqiptarë kanë në Gjykatën e Strasburgut, rrjedhojë e vendimmarrjeve të së cilave ne sot jemi këtu, të majtë dhe të djathtë, pavarësisht se akuzojmë njëri-tjetrin, jemi të gjithë të akuzuar? Sa është vlera që shteti shqiptar duhet të paguajë për të gjitha këto vendime?

Fatmir Xhafaj – Kush do të përgjigjet?

Po, zoti zëvendësministër.

Idlir Peçi – Është një çështje për të cilën do të kërkoja mirëkuptimin tuaj, që ndoshta në një seancë tjetër ne ta përgatisim, se duhet të gjejmë të dhëna të sakta, sidomos nga Avokatura e Shtetit, e cila mban edhe lidhje direkte me Gjykatën e Strasburgut. Nëse më lejoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë rreth 400 çështje, por nuk e kam të saktë. Vlera tjetër nuk mund të nxirret, sepse është tjetër gjë çfarë kërkojnë subjektet në gjykatë dhe çfarë akordon në Gjykatën e Strasburgut. Pra, ajo do të jetë spekulative nëse jap një vlerë të saktë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Majko, keni pyetje tjetër? Nuk keni.

Faleminderit!

Fjalën e ka, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Në fakt, unë kam disa pyetje dhe do t’i bëj bashkë të gjitha. Kështu që mund të përgjigjen i në fund.

Kjo është hera e parë që flisni për prona pas 2 vjetësh që keni marrë pushtetin, edhe pas premtimeve, në fakt, flet Kryeministri, jo ju. Ai ka sjellë një draft në bazë të premtimit se do t’i kthente pronat 100%, do të shkonte në Venecia, do të merrte të gjithë arkivin dhe do t’ua kthente pronarëve të gjitha pronat. E vetnja gjë që ka ardhur është vetëm reduktimi i fondit të kompensimit dhe instalimi i parimit që ndoshta bie dakord, edhe ndonjë kolegë këtu: mashtro dhe fito zgjedhjet. Ky parim po kthehet në instrument. Me të njëjtën logjikë po ecim edhe sot.

Tani, ju sot thoni se kompensimi do të bëhet me vlerën e shpronësimit, pra me vlerën e shpronësimit të bërë nga diktatori Enver Hoxha në vitin ’45. Ndërkohë që Strasburgu, siç u pyet më përpara, jep shpërblimet me miliona euro, edhe vendimi i fundit është 5 milionë euro. Pse na kërkonin neve, deputetëve, të votojmë një që u bie në ballë vendimeve të Strasburgut?

Ju thatë se ligji vë në diskutim të thellë parimin e sigurisë juridike, pra të atyre që kanë marrë vendimet deri më sot, por këtë po e bëni për të mirën publike. Pyetja e dytë është: pse

ne, si deputetë të Komisionit të Ligjeve, pavarësisht se kujt krahu i përkasim, duhet të votojmë një ligj, i cili i bie në ballë Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila garanton parimin e sigurisë juridike?

Ju thoni se duhet të votojmë një ligj, i cili do t'i kompensojë pronarët me vlerën e vitit '45, ndërkohë që një pjesë e pronarëve, përfshirë edhe këta që kanë marrë vendimin në Gjykatën e Strasburgut, edhe Manushaqen, që na u citua pak më përpara, i kanë marrë me çmimet e vitit 2015. Pse duhet të votojmë në një ligj, i cili i bie në ballë parimit të barazisë mes palëve, këtij që i marrin në Strasburg me miliona dhe atij të Kryeministrit Rama, që i marrin lekët me qindarka të shpronësimit të vitit '45?

Ju na thoni këtu, duke cituar neni 6 të projektligjit, se pasi t'i llogarisni kompensimin me çmimet e qindarkave të Enver Hoxhës, kur i ka sekuestruar, do të bëni një rivlerësim dhe në qoftë se ndonjëri ka marrë me vlerën në euro dhe jo me qindarkat e kohës së Enverit, atëherë do t'ia merrni këtë pjesë. Tani, këtu kam dy nën pyetje të tjera: ku e gjeni ju të drejtën që të rishikoni vendimet e dhëna më përpara, ndërkohë që ka të paktën një 10 vendime të Gjykatës Kushtetuese, që e ndalojnë qeverinë të rishikojë vendimet? Pyetja e dytë: pse duhet votojmë në një ligj që u bie në ballë vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?

Pyetja e fundit: ore, ja e morët se e miratuat, se një ligj me shumicë të thjeshtë është. Ja e morët dhe e miratuat këtë projektligj, kundër pronarëve dhe kundër të gjithëve, sepse i keni votat, por sa realist, i matshëm është ky projektligj që po sillni këtu, duke rishikuar 56 mijë vendimeve që kanë dalë deri më sot? Në dijeninë time janë 58 mijë vendime dhe janë dhe 5-6 mijë që thatë se janë në arkiv, me aq informacion sa kam unë. Tani sa realist, i matshëm është ky projektligj që po sillni sot këtu, ku do të rishikoni 58 mijë vendime, në qoftë se ndonjëri ka marrë më shumë, do t'ia hiqni dhe ndërkohë që suksedimi i pronës gjatë këtyre 25 vjetve ka kaluar me dhjetëra e dhjetëra pronarë, me qindra e mijëra gjyqe që janë bërë dhe ka kaluar nga ai që mund ta ketë marrë vendimin në '95-ën, sot në vitin 2015, kushedi sa pronarë të tjerë kanë dalë, duke ndërtuar pallate? Sa realiste është kjo apo është vetëm propagandë qeveritare? Kaq kisha.

Fatmir Xhafaj - Zoti zëvendësministër, do të përgjigjeni ju?

Idlir Peçi – Unë do të doja që në parim t'u përgjigjesha disa pyetjeve të zotit Halimi, faleminderit për pyetjen, pasi disa nga pyetjet tuaja janë edhe shqetësimet tona!

E përmendi edhe ministri në fillim, kemi një konfrontim të parimeve juridike, kushtetuese, siguria juridike, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, eficiencën e zbatimit të ligjit. Dua të them se të gjitha këto parime juridike, që ju i përmendët, që u shtruan në diskutim nga ne si koshientë, e dimë se mund të ketë probleme ose e dimë që është pikë diskutimi, prandaj

e shtruar që në fillim, sepse nuk duam të fshihemi pas gishtit për këtë gjë, dua të theksoj në nivel parimesh se këto parime kushtetuese janë kumulative dhe duhet të merren në një kontekst të caktuar. Duhet të shikohet balanca ndërmjet të gjitha parimeve kushtetuese dhe të shikohet se kush është ai prevalon nga njëra anë.

Lidhur me pyetjen tuaj të tretë, sa realist është një ligj, do ta lidh, gjithashtu, prapë në parim, me barazinë që ju përmendët përpara ligjit, se përmendët Gjykatën e Strasburgut, në fakt, Gjykata e Strasburgut e dënon shtetin shqiptar ose jep vendime kundër shtetit shqiptar në përgjithësi për zvarritje të ligjit dhe për moszbatim të ligjit ekzistues, i cili ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka zvarritje të zbatimit të ligjit dhe pikërisht kjo është arsyeja pse ne po dalim me një ligj, i cili mendojmë se është më realisti për momentin, duke parë gjithashtu dhe faturën financiare, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, edhe mundësitë financiare të shtetit shqiptar.

Për sa u përket teknikalliteteve, do të doja t'ia jepja fjalën, zonjës Qato.

Sonila Qato – Zoti Halimi, nuk është e vërtetë që projektligji u referohet çmimeve të vitit '45. Në asnjë paragraf, fjalë apo germë të këtij projektligji nuk e gjeni këtë lloj deklarate.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Halimi, nuk është e vërtetë që përdoret çmimi i vitit '45 në projektligjin që kemi paraqitur pranë jush, por përdoret çmimi i hartës së vlerës së pronës, një çmim i cili nxirret bazuar në një VKM, që përcakton metodologjinë e nxjerrjes së hartës së vlerës së pronës, të miratuar nga ana e qeverisë suaj, kur ju keni qenë ministër Drejtësie, dhe e keni mbrojtur me shumë flakë dhe zjarr këtë metodologji në vitin 2012.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Metodologjia e përcaktuar në vendimin e qeverisë së miratuar në vitin 2012, si një nga sukseset e asaj kohe, e cila më në fund nxirrte një çmim tregu për sa i përket vlerësimit të tokës dhe zërave kadastralë që kjo hartë vendoste në përbërje, përbën edhe vlerën e tregut, e cila përdoret sot si shtylla kryesore e llogaritjes së vlerësimit ekonomikë të të gjitha vendimeve që presin të kompensohen. Pra, nuk ka çmim të vitit '45, nuk e gjeni këtë lloji përcaktimi në asnjë dispozitë, paragraf, nen, apo germë të këtij projektligji.

Së dyti, është kuptuar apo keqkuptuar fakti që ky projektligj do të marrë në rishqyrtim 58 mijë vendimet e dhëna, të cilat nuk janë kaq, janë më pak, në 23 vjet proces. Jo, nuk është kjo! Ky projektligj po merr në konsideratë 26 mijë vendimet që kemi konstatuar sot zyrtarisht në këtë proces, të cilët kanë vendosur kompensimin e pronave nëpërmjet vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyrrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo të Agjencisë.

Këto vendime, të cilat janë përfundimtare, pra janë të pandryshueshme, do t'i nënshtrohen vetëm vlerësimit ekonomik të tyre për sa i përket vlerës sa i kushtojnë pronarit, pra sa do të përfitojë pronari, i cili për herë të parë sot do t'i llogaritet 100% e pronës, që këtij pronari i është njohur për kompensim, mbi bazën e vendimeve të lëshuara nga komisionet përgjegjëse gjatë këtij procesi 23-vjeçar. Pra, nuk do të ketë rishqyrtim të vendimeve. Vendimet e komisionit, bazuar edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, janë quajtur *cuasi* gjyqësore dhe si të tilla nuk ka autoritet administrativ, i cili mund t'i preki apo t'i cenojë këto vendime. Ne hyjmë vetëm në një proces administrativ për shkak të llogaritjes së vlerës ekonomike, një e drejtë ku çdo pronar ka nevoja ta dijë sot në vitin 2015 se sa lekë apo sa vlerë ekonomike tokë, fond fizik pret nga shteti shqiptarë kundrejt të drejtës së tij të përcaktuar në vendimin që ai ka në dorë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Eduard Halimi – Harta e vlerës, në fakt, është një nga punët e mira që është bërë aty. E rëndësishme se para komisionit ne duhet të jemi korrektë dhe të flasim sipas atyre që kemi përpara, të shkuara e zeza mbi të bardhë.

Neni 6 a parashikon që prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit? Pastaj unë me Pandin do të zihem nëse ka ndodhur në vitin '45, '46, apo në '76, kur e ka bërë Kushtetutën Njaziu me Luan Omarin, por është tjetër gjë ajo. Po them, a parashikohet kjo këtu, e zeza mbi të bardhë, që do të bëhet në bazë të kohës, duke pasur parasysh kohën e shpronësimit?

E dyta, a janë vendimet e Gjykatës së Strasburgut, “Manushaqe Puto” dhe nja 10 të tjerë, të cilët e kanë detyruar shtetin shqiptar që të paguajë 3-6 milionë euro për toka bujqësore, që mund të kenë qenë atëherë në zërin kadastral toka bujqësore, me çmime me qindarka dhe pastaj sot janë ndërtuar pallate, në mos gaboj aty te furra e bukës ka qenë njëri nga ato historitë e Gjykatës së Strasburgut, dhe e ka detyruar të paguajë miliona euro?

Tani, pse na sillni ju një ligj, ku Gjykata e Strasburgut thotë: “T’u jepet pronarëve me vlerën tregut sot, me zërin kadastral që ka sot si truell”, dhe ju na i sillni me vlerën e kohës së shpronësimit të '45-ës, '46-ës, dhe '76-ës, apo kur kanë qenë me këtë ligj? Pra, pse duhet të votojmë një ligj, i cili i bie në ballë?

E dyta, thatë se nuk do t'i rishikoni vendimet këtu, ndërkohë që neni 6, pika 5, a ka rishikim të vendimeve nga ATP-ja? Ndërkohë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese thonë jo, nuk duhet t'i rishikoni vendimet. Nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i

kompensohet fizikisht sipërfaqja që korrespondon vlerësimet dhe pjesa tjetër i merret këtij dhe i kalon shtetit. A ka këtu, sipas këtij përcaktimi, një shpronësim të ri, që u bëhet atyre që mund të ketë 20 vjet? A është realist, a është e mundur? Thashë, kjo nuk ndodh kurrë!

Fatmir Xhafaj – Zonja Qato.

Sonila Qato - Vendimet e Gjykatës së Strasburgut, të dhëna deri më sot për çështjet që kanë trajtuar pjesën e kompensimit të pronarëve kryesisht, janë vendime, të cilat kanë bërë një përllogaritje të dëmshpërblimit bazuar në vlerën e tregut. Vlera e tregut, ramë dakord të gjithë këtu, është zyrtarisht harta e vlerës së pronës, e miratuar çdo vit sipas metodologjisë përkatëse.

E njëjta logjikë dhe i njëjti parim njihet dhe ruhet në projektligjin që keni përpara, në nenin 6 të tij. Rregulli që e shoqëron përdorimin e vlerës së tregut për përllogaritjen e vlerësimit ekonomik të vendimeve që presim të kompensohen, shoqërohet po e citoj, përcaktuar te neni 6, pika 1, germa “a”: “Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën shpronësimit”.

Atëherë, pyetja që grupi i punës ka parashikuar kur ka marrë përsipër hartimin e një projektligji të ri apo të një politike të re për trajtimin e kësaj fushe është: a ka mundësi shteti shqiptar me mekanizma dhe instrumentet teknike dhe ligjor, të cilët janë deri më sot, të mund të realizojë kompensimin e pronarëve, bazuar në vlerën e tregut dhe në zërin kadastral që sot figuron prona? Nga eksperiencia e deritanishme është konstatuar se, me gjithë vullnetin e mirë që kanë pasur, ashtu siç e tha dhe ministri i Drejtësisë, të gjitha qeveritë në fushën e kthimit dhe të kompensimit të pronave në 10 vjet proces vetëm 16 hektarë pronë pjesërisht u është kompensuar pronarëve...

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Majko, ta dëgjojmë zonjën!

I është bërë pyetja, zonja po përgjigjet, sepse përgjigjja është në procesverbal.

Zonja Qato, ju lutem, vazhdoni, përmbylleni!

Sonila Qato – Pra, pyetja që i kemi shtruar vetes për të hartuar këtë projektligj është çfarë mundësie ka shteti shqiptar dhe qeveria sot, por edhe qeveria dje dhe qeveria nesër, të mund të realizojë brenda një afati të arsyeshëm, ashtu sikurse është rekomanduar nga vendimi pilot i Gjykatës së Strasburgut, procesin e kompensimit të pronarëve, duke iu referuar çmimit të tregut, sikurse dhe ky projektligj e ka në përbërjen e tij, dhe zërit kadastral që prona ka sot, në momentin që do të realizohet kompensimi. Na rezultoi se, me gjithë vullnetin e mirë që ka pasur qeveria e kaluar, nga viti 2005 deri në vitin 2013, kemi konstatuar se është arritur t’u

kompensohen pronarëve në këtë proces vetëm 15. 6 hektarë tokë, përkundrajt 75 mijë hektarëve tokë që presin të kompensohen.

Në qoftë se do të vazhdonim me të njëjtit instrumente e mekanizma shumë të mirë – sepse pritshmëria e pronarëve ndaj këtyre mekanizmave ishte optimale –sipas një llogaritjeje shumë të thjeshtë matematikore, shtetit shqiptar dhe qeverisë do t'i nevojiteshin 4000 vjet për të plotësuar kompensimin e pronarëve.

Në qoftë se duam të vazhdojmë kështu, dhe pronarët janë të kënaqur, që të mund të përfundojnë e të realizojnë të drejtat e tyre të rrjedhura për shkak të këtij procesi, nëpërmjet vendimeve që kanë në dorë, të kompensohen për një periudhë 4000-vjeçare, në rregull, unë mendoj se nuk ka shqetësim. Por fakti se Gjykata Europiane e Të drejtave të Njeriut i tha shtetit shqiptar në vitin 2012, se ju vetëm merrni masa efektive, për të identifikuar një mjet të brendshëm efektiv për ta zgjidhur këtë problem, tregon se qeveria duhej të gjente mjetin e brendshëm efektiv.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull!

Zoti Qefalia, pyetje, ju lutem.

Mbylleni mikrofonin!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt unë kisha tri-katër pyetje, por...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë i përkas asaj kategorie të pronarëve, që nuk janë pronarët e rinj që u bënë nga 1992-shi e më pas, apo që vazhdojnë të bëhen, por ish pronarëve. Jam i shqetësuar për shumë gjëra, dhe disa nga përgjigjet e pyetjeve që kisha, i mora në përgjigjet e pyetjeve që iu adresuan zotit Halimi, gjëra për të cilat kam rezervat e mia dhe që do t'i shpreh edhe në parlament. Do të isha i interesuar drejtpërdrejt për pyetjen: a cenohet fondi i kompensimit të tokës nga ALUIZNI, i cili vazhdon edhe sot të shpërndajë tapi në truallin e ish-pronarëve?

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Sonila Qato – Zoti Qefalia, procesi i nisur paralelisht, ai i trajtimit të sipërfaqeve të tokës me ndërtime informate nga ALUIZNI, nga procesi i nisur, ka qenë një ndër elementët dhe kritikën, të përmendura si fakt edhe në vendimin pilot të Gjykatës së Strasburgut.

Është konstatuar fakti se kjo veprimtari paralele, e cila trajton tokën, është bërë pengesë për përfundimin në kohë reale të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, pasi

legjislacioni apo ligji 9235 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” e pezullonte procesin e njohjes së pronësisë, kthimit dhe kompensimit të pronave në ato zona që ishin të mbuluara me ndërtime informale. Kjo i penalizonte të gjithë pronarët dhe të drejtën e tyre për të gëzuar atë të drejtë që ata e gëzonin për shkak të ligjit dhe sigurisht për shkak të Kushtetutës, më së pari.

Për këtë arsye, neni 24 i projektligjit, që merret me trajtimin e pronës në tokat e zëna me ndërtime pa leje, me pak fjalë ka parashikuar se brenda territoreve të zëna, të deklaruara informate, kryesisht nuk lejohet kompensimi fizik, por në raste përjashtimore, aty ku prona është e lirë, mund t’u kthehet pronarëve, por pa e mbajtur zvarrë procesin e njohjes së kthimit dhe kompensimit të këtyre pronarëve – të cilëve u ka rënë fati të jenë brenda zonave informale – pa e marrë zvarrë këtë proces nga procesi i ALUIZNI-t.

Kjo është një tjetër risi dhe një lehtësim në favor të pronarëve, e cila heq atë çengelin, që deri më sot ua kishte vënë atyre ligji aktual për trajtimin e këtyre zonave. Prandaj është bërë parashikimi në nenin 24, i cili trajton posaçërisht këtë problematikë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Mediu, ju lutem!

Fatmir Mediu – Ju vetë shtruat një pyetje, zonja drejtoreshë, nëse ka mundësi shteti shqiptar të plotësojë detyrimet financiare apo të kthimit të pronës të pronarët e ligjshëm. Problemi këtu është se me ç’lloj shteti duhet të gjykoni ju, kur bëni ligjin. Shtetin që do të bëjë veten pronar, duke marrë pronat e pronarëve dhe duke legalizuar të paligjshmit apo shtetin që duhet të respektojë të drejtat? Pa dyshim që shteti i ka të gjitha mundësitë – po jua kthej përgjigjen – në qoftë se do të rishikojë ligjin 7501, që ishte një ligj tërësisht komunist, për t’i dhënë gjithsecilit, sipas interesave politike.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu!

Fatmir Mediu – E dyta, po ju them se shteti ka po ashtu mundësi të padiskutueshme, në qoftë se nuk do të jepte për fond nga fondi i pronarëve, legalizim falas, duke mos ardhur asnjë qindarkë në xhepin e pronarëve, të cilëve u merret prona dhe legalizohet falas, dhe çdo vit shtohen zonat informate për t’u legalizuar. Sepse, në qoftë se do të kishim mbetur vetëm me kuadrin kur është bërë që në fillim ligji i pronave dhe hapësirave, edhe mbas legalizimit, shteti do të kishte pasur më shumë mundësi për kthim fizik e për kompensim fizik.

Ka edhe një mundësi tjetër, që ka aplikuar kjo qeveri. Detyrimet që ka pasur, rreth 700 milionë pretendimi i qeverisë për bizneset, sipas pretendimit të qeverisë, TAÇ- i i ka kryer në rreth një vit e gjysmë, duke marrë kredi e borxhe.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Unë kam një pyetje për ju, se përse e ngritët çështjen për sa i përket funksionimit të dy drejtimeve të kundërta, ALUIZNI-t dhe Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Ju që pretendoni se duhet të ktheni të paligjshmen duke legjitimuar pronën, si agjenci e kthimit dhe kompensimit të pronave, sa personel keni në raport me ALUIZNI-n, në mundësi, që legjitimon të paligjshmen, duke ua marrë pronarëve të ligjshëm apo qoftë dhe shtetit, atë pjesë të mundësisë për kompensim financiar. Cilat janë raportet tuaja institucionale, sepse në përgjigjet e pyetjeve thatë se jeni marrë me ndërtimin e hartës dixhitale apo me ndërtimin e kadastrës së pronave e të tjerë, dhe nuk jeni marrë me shqyrtimin e dosjeve. Kjo ngaqë keni pasur pamundësi? Sepse normalisht një agjenci duhet t'i kryejë të gjitha funksionet që i ka ngarkuar ligji, apo jo?

Pra, kemi një agjenci gjigante të ALUIZNI-t, ku merr pjesë në mënyrë aktive gjithë politika, jo vetëm sot e më përpara, por sidomos tani, gjë që e pamë edhe në zgjedhjet lokale. Pra, me të gjithë arsenalin e mundshëm, për të falur atë që s'është e vetja, për t'u bërë gjeneroz për arsye politike. kemi një sjellje tërësisht absurde edhe me këtë projektligj, në kundërshtim me vendimet e Gjykatës së Strasburgut dhe me Kushtetutën, për atë që është e ligjshme, për atë që ngriti edhe zoti Qefalija.

Pyetja e dytë është kjo: keni vendime të Gjykatës së Strasburgut, që njeh të drejtën e pronës dhe kompensimin e saj sipas vlerës së tregut, keni vendime të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, mbi 70 mijë dosje për kthimin dhe kompensimin e pronave, deri më sot, që janë bërë fakt, dhe keni po ashtu një arsyetim rishqyrtimi – ose po e lë rishqyrtimin – vlerësimi sipas kohës së shpronësimit. A janë këto me dy standarde? Pra, një vlerësim sipas kohës së shpronësimit dhe një vlerësim sipas Kushtetutës dhe vendimit të Gjykatës së Strasburgut neni 41? Kemi një qeveri që nuk ka barazi përballë ligjit? E tha zoti Halimi, po për ta sqaruar edhe një herë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Dakord! faleminderit!

Tani përgjigjet për dy pyetjet shitesë të zotit Mediu.

Sonila Qato – Pyetja e parë nuk është teknike, dhe unë nuk jam e autorizuar të kthej përgjigje.

(Diskutim pa mikrofon)

Në rregull!

Projektligji do të shoqërohet edhe me masa, të cilat janë parashikuar paraprakisht edhe në buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm, të cilat do të implikojnë rritjen e burimeve njerëzore pranë agjencisë së re që krijon ky projektligj, në mënyrë të atillë që të mund të përballojë afate

të cilat janë shumë të ngushta – shumë e vërtetë – por që duhet t'i marrë përsipër, në mënyrë që ta zbatojë këtë mision nëpërmjet këtij projektligji.

Ndërkohë, për sa i përket standardit të dyfishtë, unë do të doja të bëja vetëm një analizë. Si bëhet sot shpronësimi i tokës bujqësore, kur në këtë tokë bujqësore kalon një autostradë, e cila automatikisht ia ndryshon pronës regjimin juridik, duke e kthyer nga zë kadastral “tokë bujqësore”, në zë kadastral “tokë-truall industrial”. Pronari shpronësohet me vlerën e pronës si “tokë-truall industrial” apo shpronësohet për interes publik, si tokë bujqësore?

E njëjta logjikë është përdorur edhe në rastin e këtij projektligji, duke përcaktuar dhe duke mbajtur disa norma, tashmë të vendosura e të pranura nga të gjithë, në funksion edhe të procesit të shpronësimit si një proces më vete, edhe në procesin e kompensimit si proces më vete. Në të dyja rastet kanë të bëjnë me një vlerësim të pronës dhe një kompensim të drejtë, që pronari duhet të marrë kundrejt kësaj prone.

Farmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Zonja Hysi, pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, si bashkërelatore, synova të dëgjoja me vëmendje pyetjet e kolegëve, duke ruajtur të drejtën të dëgjonim edhe palët e interesuara, por sot kam nevojë të sqaroj dy gjëra, dy pyetje: njëra lidhur me metodologjinë e vlerësimit, ndërsa e dyta për ankandin.

Në ligj parashikohet që do të përdoren dy metoda të vlerësimit për kompensim. Njëra metodë është për pronën e njohur, ndërsa metoda tjetër ka të bëjë me pronën e kthyer. Nëse e kam kuptuar qartë.

A mund të na sqaroni pak më mirë se cila është metodologjia që do të ndiqet për pronat e kthyera.

Pyetja e dytë ka të bëjë me ankandin për fondin e tokës. Ligji përcakton ankandin për fondin e tokës që është pronë-shtet, por si do të veprohet, nëse një subjekt është pronar i një X metër ose X hektar për kompensim, dhe hyn në ankand për të marrë kompensim fizik për një vlerë që është shumë më pak se ajo për të cilën ai realisht është realisht pronar.

Ju thoni në ligj, se për pjesën e mbetur ai duhet të heqë dorë, nëse shpallet fitues. A cenohet këtu e drejta e tij për kompensim të drejtë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet? Zonja Qato? Po.

Sonila Qato – Pyetja e parë ka lidhje me nenin 6 të projektligjit: “Metodologjia e vlerësimit”. Në rastin e pyetjes tuaj më konkrete, për sa i përket procesit të kthimit, janë dy elementë, të cilët dua t’i sqaroj paraprakisht.

Në qoftë se jemi duke folur për vlerësimin ekonomik të 26 mijë vendimeve, tashmë të dhëna nga komisionet, atëherë këtu kemi disa raste për të trajtuar. Kemi raste në të cilat, vendimi i komisionit ka përcaktuar 100 % të pronës së njohur për kompensim. Në këtë rast prona do të llogaritet sipas zërit kadastral që ka pasur në momentin e shpronësimit, në rast se 100 % e sipërfaqes së saj, herë vlerën që ka harta e vlerës së pronës në këtë moment.

Në rastet kur brenda një vendimi komisioni kemi njohje pronësie, kthim prone dhe kompensim prone, dhe jemi në kushtet e ndryshimit të zërit kadastral – që do të thotë se prona, në momentin e shpronësimit ka qenë tokë bujqësore, por që sot është tokë-truall – atëherë hyn në funksion ai element i formulës, i cili ka të bëjë me vlerën e shtuar të pronës. Kjo do të thotë se prona e kthyer, të cilën tashmë pronari e gëzon prej vitesh, sepse e ka regjistruar në hipotekë dhe mund ta ketë vendosur edhe në qarkullim civil, vlerësohet, i jepet një vlerë ekonomike sipas zërit aktual kadastral që ka, pra truall, sikurse vlerësohet edhe vlera ekonomike që do të kishte kjo tokë e kthyer, në momentin e shpronësimit. Bëhet diferenca e kësaj shume të përfutur, e cila është e barabartë me vlerën e shtuar të pronës, për shkak të ndryshimit të regjimit, pra të zërit të saj kadastral. Në të njëjtën kohë llogaritet edhe vlera ekonomike që ka sipërfaqja, për t’u kompensuar pronari. Diferenca që do të rezultojë, do të jetë dhe vlera që pronari do të marrë në dorë, në formën e një kompensimi financiar apo fond fizik, në qoftë se do të konkurrojë si i tillë.

Pra, pjesa e kthimit të pronës do të merret në shqyrtim nëpërmjet kësaj formule vetëm në ato raste kur ka vendim, në dispozitë të së cilës është realizuar kthim prone, në momentet kur kemi ndryshim të zërit kadastral të pronës.

Për sa i përket pyetjes së dytë, në lidhje me ankandin dhe konkurrueshmërinë që do të kenë pronarët në ankand, grupi i punës e ka përqasur procedurën e ankandit si një nga procedurat më transparente, ku palët janë të barabarta përpara konkurrueshmërisë që ata do të kenë në përfitim të një prone që është pjesë e fondit fizik.

Siç e thashë edhe pak më parë, deri më tash nuk ka pasur procedura të përcaktuara për shpërndarjen e fondit fizik. Një nga procedurat më të njohura kanë qenë ato të përdorura në vitin 2005, kur ka ndodhur lotaria me gogla për shpërndarjen e fondit fizik.

E kemi parë ankandin si një procedurë e cila rrit transparencën dhe pjesëmarrjen e të interesuarve brenda këtij procesi. Procedura e ankandit do të shoqërohet me dy mjete apo me dy mekanizma, le të themi. Nga njëra anë agjencia do të vlerësojë ekonomikisht të gjitha

parcelat e fondit të tokës, pasuri-shtet kjo, status juridik i pastër shtet, duke i dhënë një vlerë ekonomike, dhe do t'i shpallim në ankand. Pronarët, të cilët në duart e tyre, pas tre vjetësh, sipas afateve të përcaktuara në këtë projektligj, do të kenë në duart e tyre vlerësimin që do t'i jetë bërë vendimit të tyre për kompensim, do të vendosin vetë nëse do të marrin pjesë në këtë ankand apo jo. Sigurisht, është normale që çdo pronar të marrë pjesë në një ankand, ku vlera ekonomike e pronës që ai pretendon të kompensohet fizikisht të jetë afërsisht e barabartë apo e barabartë, por mund të jetë edhe më e madhe, nga vlera e pronës e cila do të përfitojë nga ankandi.

Në logjikë dhe në parim flasim për diferenca të vogla, prej të cilave pronari mund të heqë dorë, duke u kënaqur nga prona që do të marrë në ankand si kompensim fizik.

Gjithsesi, në qoftë se ka nevojë për ndonjë rregullim, që të bëhet më e qartë dispozita përkatëse në projektligj, kjo është në diskrecionin tuaj për ta rregulluar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Besoj se ia vlen për t'i bërë edhe këto pyetje shtesë.

Ju shpjeguat formulën. Në fakt, kur unë jua bëra më të thjeshtë, nëpërmjet atij ushtrimit, ju thatë: “Jo, nuk është kështu!”

Pra, sot personit do t'i vlerësohet prona, nëse do t'i kthehet, sepse është e gjitha e lirë. Do t'i vlerësohet me vlerën e sotme, me vlerën e djeshme dhe do të marrë aq sa totali i pronës së dikurshme do të vlente dje. Pra, në qoftë se nga 1000 metra do të marrë 100 metra, aq do t'i jepni ju. Ky është ushtrimi që ka ligji. Është mirë që ta thoni se ata që kanë 1000 metra, nuk do të marrin 1000 metra por 100, ndërsa 900 të tjerat do t'i shpronësojë shteti, sepse do t'i fusë te llogaria e fondit të kompensimit fizik.

Mos thoni jo, sepse kështu është.

S'kam mbaruar.

Tani një pyetje. Nëse dikush ka pasur fatin ta marrë të gjithë pronën, me kthim të plotë dhe s'ka asgjë tjetër. Ju s'i jeni borxh. Madje me këtë ligjin, ai s'ju është më borxh juve, sepse e ka mbyllur punën me ju. Nëse një personi i kaloka sot rruga të prona e tij, ai do të shpronësohet me vlerën e 45-ës, 46-ës, apo 76-ës, po deshët ju, apo me vlerën e sotme? Ky është pronar i rikthyer në të drejtën e tij. Pra, me çfarë vlere, sepse këta që janë, që i ka zënë halli me ju sot, shkojnë në këtë drejtim, kurse ky që ka mbaruar hesapin me ju, më thoni, si do të shpronësohet, me vlerën e atëhershme apo me vlerën e tregut, qoftë edhe hartë e vlerës?

Nëse dikush e ka marrë kompensimin të plotë dhe e ka mbyllur çështjen financiare, e ka marrë me hartën e vlerës, po themi, të 2012-ës, çfarë do të bëni ju me këtë? Meqenëse ky

ka marrë më shumë nga ç'i takonte me ligjin e sotëm. Ku qëndron barazia me atë që do të aplikohet sot?

Kam edhe një pyetje tjetër.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Besoj jam i qartë.

Fatmir Xhafaj – Po, po.

Idlir Peçi – Nëse mundem, për pyetjen e dytë të zotit Bylykbashi, të them të drejtën është pyetje me shumë vlerë, dhe juridikisht është një pyetje për të cilën duhet të ulen e të vrasin mendjen shumë juristë, që ta zgjidhin, por fatkeqësisht nuk është subjekt i këtij ligji.

(Diskutim pa mikrofon)

E njoh që është një pyetje shumë e drejtë dhe që duhet të ulen shumë juristë për ta zgjidhur, por fatkeqësisht nuk është subjekt i këtij ligji, kështu që nuk besoj se mund të hyjmë në diskutime.

Për sa u përket pyetjeve të tjera konkrete, zonja Qato do t'u japë përgjigje.

Sonila Qato – Nëse do ta trajtonim sipërfaqen e tokës që preket sot për një interes publik, për shpronësim, dhe do ta trajtonim ashtu sikurse ju e thatë – sepse projektligji nuk ka çmime të 45-ës e as të 76-ës, por ka çmimet e tregut, pra të hartës së vlerës së pronës – sigurisht që do të ishim në cenim të rëndë të sigurisë juridike. Kjo nuk ndodh, dhe në dijeninë time nuk është e parashikuar as të ligji “Për shpronësimet”, për sa e njoh atë ligj, por nuk parashikohet as në ligjin aktual.

Ato vendime, të cilat në dispozitivin e tyre kanë pasur vetëm kthim, pra njohje dhe kthim, ato janë të përfunduara tashmë. Besoj se janë të regjistruara apo kanë vijueshmërinë e tyre të regjistrimit në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe përdoren, disponohen nga pronari, ashtu sikundër disponohen të gjitha pasuritë e paluajtshme, që dikush i ka në pronësi.

Në lidhje me nënvizimin tuaj për sa i përket formulës, mbetem prapë në të njëjtin opinion. Shembulli që ju dhatë, për 1000 metra katrorë apo 10000, ç'rëndësi ka, kur janë të lira sigurisht do t'u kthehen pronarit, duke zbatuar formulën e përcaktuar në këtë projektligj. Kjo është ajo çfarë e bën këtë projektligj të ndryshëm nga ligji që kishim në fuqi deri dje, deri më datën 30 tetor. Nuk mund të ushtrojmë procese dhe parime të ndryshme brenda të njëjtit ligj. Thelbi i këtij ligji është përcaktimi i një formule, e cila duhet të jetë e zbatueshme në të gjithë trupin e tij të dispozitave, ndaj nuk ka ndryshime në këtë aspekt.

Do t'i nënshtrohet formulës, sipas nenit 6 të këtij projektligji, çdo dosje që do të merret në trajtim, e cila është ende pa vendimmarrje në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të

pronave, apo atë që do të mund të dalë nga ky projektligj. Duke zbatuar këtë formulë brenda metodologjisë së vlerësimit, të përcaktuar në nenin 6, do të vendoset edhe kthimi fizik i pronës te pronari i cili e pretendon. Pra nuk është hequr koncepti i kthimit të pronës, ashtu sikurse është pretenduar. Përkundrazi, ky koncept është ruajtur, por është formalizuar nëpërmjet rregullit të përcaktuar në nenin 6 dhe 7 të projektligjit.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zonja drejtoreshë, problemi është se juve keni një konflikt me konceptin e pronës që ka Kodi Civil. Në fakt, Kodi Civil nuk flet për faturë, kur flet për pronën, flet për sendin, sendin e paluajtshëm dhe pronësinë mbi të. Meqë po flasim për prona të paluajtshme. Gjëja më e thjeshtë në çdo gjykatë, ku do të përpiqesh t'i provosh gjykatës të drejtën e pronësisë, është se nuk i thua gjykatës se sa të vlen prona. Maksimumi vlen vetëm për të përcaktuar nëse do të bëhet me një gjyqtar apo me tre gjyqtarë. Ajo që do t'i provosh gjykatës, përveç dokumentacionit, janë kufijtë e sendit dhe sipërfaqen e sendit. Kjo e mbyll historinë e pronës. Në qoftë se dikur, dikujt iu morën 10 mijë metra apo 1 mijë metra – nuk ka rëndësi – për efekt thjeshtimi, me këto kufij, ato do t'i njihen dhe ato do t'i kthehen. Çdo gjë tjetër brenda saj, nuk është më ajo pronë, por është një gjë tjetër. Ky ligj është për kthimin e pronës. Gjykata kushtetuese këtë ka thënë: po vetëshpronësohemi për t'ua dhënë prapë mbrapsht pronën ish-pronarëve, sepse bëmë një gabim të tmerrshëm. Juve thoni se qëllimi i ligjit nuk është prona – sapo e thatë – por është formula. Në fakt, ky parlament nuk ka si qëllim të zvogëlojë pronat, por të kthejë pronën, të njohë një të drejtë të shkelur.

Tani po dal te pyetja tjetër. Ju shpjeguat formulën. Thatë se prona vlerësohet me vlerën e momentit të shpronësimit, prona e kompensuar, dhe me kompensim përfshini edhe kthimin, kthimin fizik. E quani kompensim fizik. Pastaj bëni edhe vlerësimin e pronës aktuale. Bëni diferencat e të tjera. Tani unë po ju kthej te një vendim i Gjykatës Kushtetuese – nuk e mbaj mend vitin e as numrin, por mund t'ua them radhës që vjen, po të doni. Ligji i vjetër i pronave, ligji i 93-shit, kishte një dispozitë: Në rastin kur kishte persona në banesën e një ish-pronari, prona i kthehej pronarit.

Kishte edhe ca elementë të tjerë, por në thelb ishte se prona i kthehej pronarit. Në rast se personi që ndodhej në pronën e ish-pronarit, e kishte blerë pronën nga shteti, mbas shpronësimit, pra diku në vitet '50, '60, nuk ka rëndësi, ndërkohë që prona i kthehej ish-pronarit, këtij personi, thoshte ligji, shteti do t'i jepte vlerën me të cilën e kishte blerë, të indeksuar. Ndërhyri Gjykata Kushtetuese dhe tha: është e drejtë dhe duhet të mbetet në ligj e drejta për të kthyer pronën, jo faturën e pronës.

Pra, për të kthyer pronën te ish-pronari. Gjithashtu, është e padrejtë, sepse cenohet në themel e drejta dhe siguria juridike që duhej të kishte ky personi tjetër. Për rrjedhojë, jo me indeksim, por me vlerën e tregut të asaj prone që do t'i kthehej ish-pronarit, në momentin kur i kthehej. Pra, e mbrojtë deri në fund parimin e pronës dhe sigurinë juridike, e cila qëndron pas parimit të pronës. Ku e shihni ju këtë në ligjin tuaj, në raport me këtë? Edhe një herë, thotë: pronën sa ç'është sot, jo pronën sa ç'ishte atëherë, kur e bleu apo e shpronësoi.

A shihni ndonjë përplasje apo thjesht nuk e shihni fare?

Sonila Qato – Faleminderit! E kemi parë me shumë seriozitet këtë aspekt, në mënyrën se si e paraqitët edhe ju, bazuar edhe në këtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por edhe në përcaktimet që ka bërë Kodi Civil apo Kodi i Procedurave Civile, në mënyrën se si trajtohet prona, kur paraqitet një padi për njohjen e kufijve të pronësisë në gjykatë. Nuk kam asnjë lloj vërejtjeje, por ky është një ligj që ka dalë në zbatim të nenit 41 të Kushtetutës, dhe është një projektligj i cili trajton një problematikë të një fushe të caktuar, e cila kërkon të rivendosë në vend një padrejtësi të shkaktuar nga sistemi komunist ndaj pronarëve, në vitet e para të atij regjimi.

Për këtë, Gjykata Kushtetuese, në një vendim të sajin nr 4, datë 8. 04. 1994 – më lejoni vetëm ta citoj – sepse i vlen projektligjit thotë: “Parimi i drejtësisë kërkon që të merren në konsideratë jo vetëm interesat e ish-pronarëve dhe të trashëgimtarëve të tyre, por gjithashtu edhe ato të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si dhe interesi publik në tërësi”.

Objektivi i kthimit të të drejtave të pronës nuk është fshirja e të gjitha padrejtësive të shkaktuara nga regjimi komunist, por zvogëlimi i tyre, ashtu siç citohet në vendim. Kërkoj ndjesë. Ky është vendimi nr. 30, datë 1. 12. 2005. Ndërkohë, vendimi i vitit 1994, i Gjykatës Kushtetuese, ka cituar më përpara se sa ky që sapo citova, se kriteri për shpërblim ose kompensim në dobi të ish-pronarëve, nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë.

Ky rregullim kushtetues i detyrohet jo vetëm funksionit të dyfishtë, privat dhe shoqëror, që mbart në vetvete e drejta e pronës, por edhe rrethanave historike, politike, ekonomike, shoqërore e juridike, të cilat kanë ndikuar në situatën e krijuar. Objektivat legjitimë të interesit publik, si ato që ndiqen në kuadrin e masave të reformës ekonomike ose masat e hartuara, për të arritur drejtësi më të madhe shoqërore, mund të kërkojnë një rimbursim më të vogël se vlera e tregut. Kjo ishte dhe përgjigja që unë kisha për pyetjen tuaj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Qato! Me sa kuptoj, nuk ka pyetje të tjera nga kolegët deputetë. Nuk ka. E mbyllem këtu këtë çështje, për ta vazhduar ditën e premte, siç e lamë, me seancën dëgjimore me grupet e interesit.

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Faleminderit, zonja Qato!

Faleminderit, zonja Treska!

Faleminderit edhe ministrit, që ishte i pranishëm dhe iu përgjigj pyetjeve.

Shihemi ditën e premte.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Nard Ndoka, Pirro Lutaj

Mungon:

Tom Doshi

Të ftuar:

Irena Beqiraj – zëvendësministre e Financave

Denada Stoja – përfaqësuese e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Enis Trushi - përfaqësuese e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji ”për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

E pranishme nga Ministria e Financave është zonja Irena Beqiraj, zëvendësministre e Ministrisë së Financave.

Atëherë vazhdojmë me projektligjin.

Kemi mbetur te pyetjet përkatëse, që mund të ketë, nëse ka të tilla edhe sot. Do t’ju lutesha që, në rast se do të ketë përgjigje, pjesëtarët e stafit, që ju shoqërojnë, të prezantohen me emër, mbiemër, për efekt të procesverbalit. Pra, të thonë emër, mbiemër, për efekt procesverbali. Natyrisht, përgjigjet mund t’i jepni ju, por mund t’i japin edhe...

Meqenëse jemi këtu, kam një pyetje që në fillim fare.

Zonja zëvendësministre, unë kam lexuar me kujdes edhe procesverbalin edhe përgjigjet e ministrit, edhe relacionin. Pyetja ime është: Çfarë e pengon dhe ç’problem do të kishte për qeverinë, nëse ne do t’i mbyllnim tërësisht të gjitha këto lojërat e fatit? Pra, nëpërmjet një moratoriumi, që këtë treg ta disiplinonim përfundimisht. Sepse, kështu siç e kemi, hiq një, vërë një, shtyj një, çon një përpara, nuk e di se sa do t’ia arrijmë të jemi të suksesshëm ëpr ta disiplinuar atë, edhe në funksion të atyre qëllimeve shumë të mira, që argumenton qeveria në relacion.

Irena Beqiraj – Faleminderit!

Në fakt, mendoj se ky ka qenë një debat që ne e kemi bërë shpesh, duke qenë se lojërat e fatit kanë krijuar në Shqipëri një plagë sociale dhe kanë ca efekte sociale negative. Por, tanimë ajo është një industri e ngritur, e cila ka një punësim. Mbase jo shumë të madh, por gati 5600 persona punojnë sot në industrinë e lojërave të fatit. Në një farë mënyre, në qoftë se do të bënim një moratorium ose do t’i mbyllnim përfundimisht ato, mendojmë se do të ishte një veprim ose një vendimmarrje, le të themi, ekstreme. Industria e lojërave të fatit nuk zhvillohet vetëm në Shqipëri, por zhvillohet dhe në një pjesë të mirë të vendeve të Europës. Ajo që duam të bëjmë me këtë ligj, është që ta kthejmë nga diçka që është më tepër një plagë sociale, në një mjet argëtimi.

Fakti se një pjesë të mirë të kazinove i nxjerrim jashtë vijës administrative dhe do t’i lejojmë të zhvillohen vetëm në vende turistike, siç është sot, le të themi, rasti i Kroacisë, vetëm në hotelet me pesë yje, do të ishin më tepër një vend argëtimi, plus për të zhvilluar turizmin, gjë që është më mirë se sa të marrim masa ekstreme për mbylljen e tyre, ndonëse, personalisht, jam kundër lojërave të fatit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Kjo është personale. Ju jeni për të mbrojtur projektin e qeverisë.

Irena Beqiraj – E thashë mendimin e qeverisë...

Fatmir Xhafaj – Për të dhënë mendim personal, e kemi vetëm ne që jemi këtu.

Irena Beqiraj – Në rregull! Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në vazhdim të logjikës tuaj, meqenëse ju e argumentoni këtë me vendet e punës e me të gjitha këto, atëherë Lotaria Kombëtare e disa të tjera, në dijeninë time nuk kanë punonjës, jo aq sa të krijojnë një problem social. Pse duhet t'i lëmë ne këto? Sepse, nga njëra anë thoni se është problemi social, nga ana tjetër thoni se është problemi financiar. Cili është nga këta? Në këtë mënyrë, arrini t'i zgjidhni?

Irena Beqiraj – U mundova të shprehja diçka tjetër. Ajo që u mundova të shprehja është që, po, është problemi social, por kjo nuk do të thotë se problemin social duhet ta zgjidhim me reforma kaq ekstreme, sa t'i mbyllim fare. kam përshtypjen se Lotaria Kombëtare ka të punësuar – unë tani nuk e kam statistikën, për t'ju thënë se sa të punësuar ka – por nga një evidencë që kemi, aktualisht në gjithë këtë industri janë investuar para nga bizneset dhe ka të punësuar. Ka një lloj prodhimi ose një lloj qarkullimi, që këto kompani bëjnë, kështu që marrja përsipër e mbylljes së tyre totale mund të zgjidhte plagën sociale, por do të krijonte disa probleme të tjera. Për rrjedhojë do të konsiderohej një veprim ekstrem, le të themi.

Këtë u përpoqa që të shpjegoj. Më tepër u munduam që me këtë ligj ta kufizojmë, ta kontrollojmë, për të marrë funksionin që ka, si një lojë edhe argëtuese, pra si një industri që edhe argëton në të njëjtën kohë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Kjo është përgjigja juaj! Faleminderit!

Zoti Manja.

Ulsi Manja – Në fakt, edhe si relator, për më tepër edhe për të qartësuar edhe opinionin publik, unë kam tre pyetje.

Pyetja e parë vjen në vijim të logjikës së pyetjeve që bëtë ju.

Zonja zëvendësministre, sa për qind e të ardhurave vijnë sot në buxhetin e shtetit nga ky lloj aktiviteti? Ose a ka ndonjë shifër se sa për qind e të ardhurave nga ky lloj aktiviteti, pra nga lojërat e fatit, vijnë sot në buxhetin e shtetit? Pyetja e parë kjo.

Pyetja e dytë është në lidhje me projektligjin. Projektligji parashikon që bingo tradicionale dhe kazinotë elektronike nuk do të jenë më të përfshira në kategorinë e lojërave të fatit, që do të lejohen të zhvillohen. Ndërkohë, në ligj parashikohet që subjekteve të cilat e ushtrojnë këtë aktivitet sipas ligjit, dhe që janë të licencuara, do t'u ndërpritet më 31 janar të vitit 2016.

A keni ju një listë se sa është numri i licencave të dhëna për këto dy kategori lojërash, të cilat nuk parashikohen më në ligjin e ri? Gjithnjë nëse e keni. Pra, një numër të këtyre licencave. Kjo është pyetja e dytë.

Pyetja e tretë është e karakterit teknik. Është një projektligj që në fakt ka shumë terma të tilla. projektligji propozon zëvendësimin e kazinosë elektronike me kategorinë e lojërave elektronike në distancë. Jam i paqartë se si do të zhvillohen dhe kontrollohen lojërat elektronike në distancë, gjithmonë në kuptimin e taksimit ose vjeljes së të ardhurave nga zhvillimi i kësaj lloji loje.

Po këtu, dua ta di se cili është dallimi mes kazinosë elektronike në distancë dhe lojërave elektronike në distancë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Zonja zëvendësministre, ju lutem!

Irena Beqiraj – Për sa i përket taksimit, tabela e të ardhurave në buxhetin e shtetit në vitin 2013 ka qenë 3. 6 miliardë lekë, ndërsa në vitin 2014, meqenëse është viti i fundit fiskal i mbyllur, ka qenë 5. 3 miliardë lekë. Në vitin 2013 qarkullimi vjetor i të gjitha lojërave të fatit ka qenë 10. 6 miliardë lekë. këto janë të ardhurat që vijnë në buxhetin e shtetit.

Ligji i ri e ndryshon metodën e taksimit, sepse sot e kemi 10 % mbi xhiron që kryejnë lojërat e fatit, ndërsa duam të kalojmë në një taksim modern, që është taksim mbi fitimin bruto nga lojërat e fatit. Mendohet se kjo do të sjellë më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, duke qenë se pjesa më e madhe e fitimit bruto nga loja është më shumë se sa 40 %, dhe për të gjitha lojërat që do të kenë më shumë se 40 %, pjesa që do të marrë shteti do të jetë më e madhe.

Për sa i përket faktit se çfarë do të bëhet me licencat e vjetra, kemi ndaluar bingo dhe kazinotë. Sot për sot kemi katër licenca bingo dhe 12 licenca kazinoje. Zakonisht këto janë pa afat. Me ligjin e kaluar nuk është se ka pasur ndonjë afat të përcaktuar, megjithatë kolegët do të bëjnë një listë, që shumë shpejt do t'ua sjellim, nëse ka ndonjë kazinotë apo bingo, që e kanë pasur të përcaktuar, po kryesisht janë dhënë pa afat.

Lojërat elektronike në distancë. Ligji i kaluar ka pasur kazinotë elektronike në distancë, ndërsa ligji i ri thotë lojërat elektronike në distancë, sepse këto mund të jenë më shumë se sa kazinotë.

Çfarë kemi aktualisht? Sot kemi një sërë uebsajtesh, të cilat nuk janë shqiptare, nuk janë të licencuara në Shqipëri, në të cilat shqiptarët luajnë. Kuptohet, këto kompani nuk paguajnë asnjë gjë në Shqipëri. Duke i lënë, duke i hequr fare, për t'iu kthyer përsëri pyetjes që më bëri zoti Xhafaj, pra duke i hequr fare dhe duke i shtrënguar mund të biem më shumë

informalitet dhe më shumë evazion. Duke mos i lënë këto lojëra fati që të licencohen, kuptohet se ato do të funksionojnë në Shqipëri në mënyrë joformale dhe pa kontroll. Kësisoj kemi vendosur që këto të lejohen me ligj, të licencohen dhe të monitorohen nga njësia e monitorimit online. Kjo është edhe një nga risitë e këtij ligji. Në IMLF do të ngrihet njësia e monitorimit online të të gjitha lojërave, ku në kohë reale, ç do lojë fati online, në internet apo jo, do të jetë e lidhur me njësinë. Teknikisht, mbase do ta shpjegojnë zotërinjtë, sepse është çështje teknologjike, por ne kemi mundësi të masim se cila është xhiroja që këto bëjnë. Kuptohet, në bazë të xhiros edhe do të taksohen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Mbaruat me përgjigjen?

Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Mua s’ më rezulton se ai aksioni i madh i famshëm prodhoi ndonjë gjë. Po aq lojëra fati mbetën. Ndoshta ndërruan vetëm duart. Pra, shou ishte.

Tani një pyetje kam: ju thoni se do ta kthejmë në argëtim dhe do të përpiqemi ta heqim si plagë sociale. Në rregull. Pse nuk i hiqni të gjitha lojërat e fatit nga qytetet dhe i nxirrni të gjitha. Në projektligjin e pak më përpara, ne diskutuam një cenim të madh të një të drejte, edhe me kosto. Nuk e dimë se ç’kosto do të ketë në të ardhmen. pse nuk i mbyllni të gjitha, pavarësisht faktit se kur e kanë marrë licencën dhe ç’afat kanë, dhe t’i nxirrni të gjitha nga qyteti i Tiranës, për shembull, dhe nga çdo qytet tjetër. Mund të jetë zgjidhje shumë e mirë, mund të jetë edhe e gabuar, por dua të di: përse nuk bëni këtë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja zëvendësministre!

Irena Beqiraj – Për s ai përket aksionit, zoti deputet, do t’ju jap vetëm disa shifra: 7080 pajisje lojërash fati dhe pajisje ndihmëse, të konfiskuara nga njësia e monitorimit të lojërave të fatit, për periudhën tetor 2013 – dhjetor 2014. Në 753 pajisje të konfiskuara, për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gati 700 % më shumë. 4783 subjekte të kontrolluara nga IMLF-ja për periudhën tetor – dhjetor, nga 622 subjekte të kontrolluara për një periudhë një vit më parë, pra 760% më shumë.

118 masa administrative gjobë për periudhën tetor-dhjetor 2014, si dhe 26 masa administrative gjobë për të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra 450 më shumë. IMLF-ja, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ka kallëzuar penalisht 35 raste të konstatimit të veprës penale të ushtrimit të aktivitetit të lojërave të fatit të palicencuara, pa ndryshuar normën e taksimit për lojërat e fatit. Për vitin 2014 kemi një rritje prej 47,8% më shumë të të ardhurave

ose 1,6 miliardë lekë më shumë. Pra, nuk mund të themi që aksioni ose lufta kundër informalitetit në lojërat e fatit ka qenë pa rezultat, pasi kuptohet që ka ende shumë për të bërë.

Në lidhje me pjesën për t'i hequr fare, unë mendoj, duke shprehur këtu edhe mendimin e qeverisë, që të gjitha vendimet, të cilat janë për heqjen fare, se do të ishte shumë mirë që t'i hiqim për një pjesë sociale që preket, por kjo do të binte në të njëjtën kohë edhe rritje të evazionit ose subjektet do ta bënin këtë në mënyrë të palicencuar. Duke qenë se është një produkt që në Shqipëri është konsumuar ose një shërbim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha, nga Tirana, nga Durrësi dhe nga të gjitha qytetet. Në qoftë se do të heqim një pjesë, pra ato që janë kazino dhe po të shihni që në ligjin bazë kemi lënë vetëm një pjesë, atë të basteve sportive, të paktën pranë Tiranës dhe i kemi bërë me distancë 200 metra larg njëra-tjetrës dhe po e njëjta distancë për sistemet e arsimit pasuniversitar dhe nga institucionet fetare, duke kufizuar numrin e nipteve sekondare brenda një nipti kryesor në 500. Pra, jemi munduar që ta kufizojmë pak a shumë, në mënyrë që ta shmangim ose ta përmirësojmë këtë plagë sociale. Por, gjithsesi do të mendoja se çdo veprim ose vendim ekstrem për heqjen në total të tyre do të zhvillonte dhe do të rriste incentivat për ta zhvilluar këtë industri në mënyrë informale, sepse në të vërtetë duhet të jemi koshientë që produkti i kësaj industrie ose shërbimet që ofron ajo sot konsumohen nga shqiptarët. Pra, duhet t'i bazohemi edhe kulturës së vendit, si dhe dëshirës.

Oerd Bylykbashi – Pra, ju po thoni që kazinoja tek Tajvani ose diku tjetër është për të na siguruar që nuk do të ketë informalitet? Pse nuk i heqim të gjitha nga qyteti dhe t'i çojmë jashtë tij? Është një plagë e madhe sociale. Para ne mbledhim dhe nuk e prishim industrinë, por larg qytetit. Pse ka preferencialitet apo klientelizëm, kjo është çështja?

Irena Beqiraj – Në ligj nuk flitet as për Tajvanin dhe as për preferencialitet. Ajo që unë po mundohem të shpjegoj është se cila është fryma e ligjit dhe fryma është pikërisht kjo, që të gjitha kazinotë do të dalin jashtë qendrave administrative, kuptohet ato që kanë një afat licence të përcaktuar. Kjo është edhe pyetja që bëri zotëria më përpara. Ne nuk mund të shkelim një të drejtë që është dhënë përsëri me ligj, por nga një ligj i mëparshëm, sepse shkelet e drejta e individit ose e subjektit, por të gjitha këto kazino që do të licencohen këtej e tutje do të jenë të gjitha jashtë qytetit. Sa të mbarojë afati i licencës së Tajvanit, unë nuk e di se kur i përfundon, por edhe ai do të jetë jashtë qytetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

Zoti Manja, a kishit ndonjë gjë?

Ulsi Manja – Unë kam diçka në drejtim të lojërave elektronike në distancë, sepse në përkufizim thuhet: “Lojtarët do të marrin pjesë nëpërmjet përdorimit të komunikimit në distancë, duke përfshirë edhe internetin”. Pra, nëpërmjet telefonit pavarësisht kufizimit të moshës, çdo person mund të marrë pjesë në një lojë elektronike në distancë. Pyetja ime është: sistemi i monitorimit *online*, pra njësia që do të ngrihet pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, a i ka kapacitetet për t’i kontrolluar *web-et* e licencuara, që sasia e parave që do të luajnë shqiptarët brenda Shqipërisë të mos transferohet jashtë Shqipërisë? Pra, a do t’i ketë ky sistem këto kapacitete që paratë të ngelen po në Shqipëri?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Fjala për ju, zonja zëvendësministre.

Irena Beqiraj – Sistemi që parashikon që ky ligj dhe që do të ngrihet është një sistem modern, teknologjik, i cili do të lidhë të gjithë aparatet, internetet, *web-et*, të cilat ofrojnë lojëra të fatit *online*. Në të njëjtën kohë për t’u futur dhe për të luajtur *online* minimalisht duhet të kesh të paktën një kartë krediti apo debiti, kështu që fëmijët nuk i zotërojnë këto karta për të luajtur *online* dhe për të fituar para. Në të njëjtën kohë, të gjitha këto kompani që do të licencohen do të kenë llogari bankare të përcaktuara, në të cilën do të kalojnë të gjitha paratë që ato do të marrin nëpërmjet lojërave *online* dhe kjo nuk është një praktikë që ndiqet vetëm në Shqipëri. Pra, ne nuk jemi duke shpikur ndonjë gjë që nuk është në vendet e tjera të botës. Në të gjitha vendet e BE-së ku ne duam të aderojmë, të gjitha lojërat e fatit *online* apo jo, makinat dhe gjithçka që ofron një lojë fati është e monitoruar me një sistem që i merr të gjitha të dhënat në kohë reale. Aktualisht ne nuk e kemi, por po punojmë që ta ngremë dhe ky ligj na krijon mundësinë që të ngremë sistemin e monitorimit të lojërave të fatit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

Zoti Muhedini.

Tahir Muhedini – Unë do të isha dakord që të gjitha kazinotë dhe lojërat të hiqeshin fare. Kam një pyetje për ju zonja zëvendësministre: a ka një afat se kur do të mbyllen kazinotë, pra të hiqen nga Tirana dhe të shkojnë atje ku thoni ju, në një destinacion tjetër?

Më pas do të vazhdoj me pyetjet e tjera.

Irena Beqiraj – Në projektligjin e parë ne e kishim lënë afatin një vit. Pra, që në momentin e kalimit të ligjit do t’u lihet një vit kohë që ato të kenë mundësinë për të lëvizur nga qendrat e qyteteve. Në të njëjtën kohë që të kemi mundësi, pasi ato kanë edhe afatet e licencave për të cilat janë licencuar. Me përfundimin e afatit të licencës së mëparshme që u është dhënë, do të rishikohet nëse i plotësojnë kërkesat për t’u licencuar sërish, sepse ligji ka ndryshuar në

një pjesë të mirë të të gjitha kërkesave të licencimit, që nga aftësitë financiare, cili e zotëron, cili është përfituesi i fundit i parave që vijnë nga aktiviteti i lojërave *online*, administratorët, bordet mbikëqyrëse, pra çdo gjë është ndryshuar dhe kërkesat e ligjit janë bërë edhe më të forta për të gjithë ata që do të licencohen për të ofruar këto lojëra.

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, të gjitha do të kalojnë jashtë qytetit dhe kjo është e përcaktuar me ligj.

Fatmir Xhafaj – Zoti Muhedini, keni pyetje tjetër?

Tahir Muhedini – Në lidhje me kazinotë që thoni ju, pasi unë dëgjova që kazinotë kanë 12 licenca.

Irena Beqiraj – Janë 4 bingo dhe 12 kazino elektronike.

Tahir Muhedini – Unë besoj se ju i keni të qarta se kush nga këta ka licencat, kush ka paguar dhe kush nuk ka paguar, kush ka qenë korrekt dhe kush jo, të gjitha këto ju i keni të pasqyruara. A mund ta di se cilat janë këto kompani?

Irena Beqiraj – Emra konkretë?

Tahir Muhedini – Po, emrat konkretë. A janë 12 licenca dhe nga këta kush ka qenë jokorrekt karshi ligjit dhe shtetit dhe cilat ka qenë korrekt, si dhe të ardhurat që kanë derdhur?

Fatmir Xhafaj – Do t'ju lutesha që ne ta rezervojmë çështjen e kompanive dhe do të sugjeroja që ju të bëni një informacion, sepse kjo mund të konsiderohet edhe reklamë dhe unë në parim jam kundër çdo lloj reklame në këtë fushë. Kështu që mund t'u jepni relatorëve dhe deputetit një informacion të detajuar nëse mundeni dhe zoti Muhedini e mirëkupton.

Irena Beqiraj – Është parimi i konfidencialitetit. Një informacion mund ta bëjmë, por nuk mund t'i themi publikisht, pasi shkelim parimin e konfidencialitetit.

Tahir Muhedini – Ju thoni që me ligj do t'i nxirrni të gjitha kazinotë jashtë qytetit në turizëm. Në turizëm infrastruktura është gati që të mbyllet kjo kazino, ta zëmë në Tiranë janë 15 apo 20 dhe do t'i çojmë në një vend turistik. A keni marrë ndonjë masë se si do të shkojnë këto? Këto kompani kanë bërë investime të mëdha dhe po i mbyllët ju ky investim ku do të shkojë? Këtë e kemi diskutuar edhe një herë tjetër para 6-7 muajve, edhe para 2 vjetve.

Irena Beqiraj – Për të gjitha kazinotë që e kanë licencën me afat, kuptohet që kur u mbaron afati dhe nuk plotësojnë kushtet e reja të ligjit është një risk që ato e kanë përsipër si çdo biznes tjetër, që duhet të përshtatet me ligjet e vendit për të vazhduar aktivitetin. Kazinotë që do të licencohen kryesisht në ligj, janë parashikuar të jenë në zonat turistike, kryesisht në hotele dhe resorte me 5 yje, pra të jenë totalisht në shërbim të turizmit. Nuk do të ketë më kazino jashtë vijës administrative pa qenë një zonë turistike dhe një vend i shpallur turistik, që të jenë të lidhura kryesisht me hotelet dhe resortet me 5 yje. Do të ketë një vendim të Këshillit

të Ministrave, i cili do të përcaktojë të gjitha kushtet që do të licencohet një kazino dhe ajo që përcakton ky ligj është se ato do të jenë të lidhura direkt me turizmin, jashtë vijës administrative dhe kushtet e tjera do të përcaktohen më pas se në cilën zonë janë plotësuar dhe sa do të jetë tarifa e licencimit që mund të ndryshojë nga vendi, nga biznesplani, si dhe ku ushtrohet aktiviteti i kazinosë.

Ndërsa për kazinotë që do të mbyllen, sepse nuk do të jenë më në funksion me ligjin ekzistues, ato i kanë licencat me afate të përcaktuara.

Tahir Muhedini – Kam edhe një pyetje tjetër. Çfarë modeli keni marrë ju që këto kazino të ikin nga qyteti dhe të shkojnë në pikat turistike? Unë mund t’u jap shumë shembuj të qyteteve europiane, të cilat i kanë kazinotë në qendër të qytetit. Ku qëndron pozitiviteti që ky lojtar nuk do të argëtohet në mes të Tiranës, por do të argëtohet në një fshat turistik, në një kohë që si ju dhe si unë, apo dhe kushdo tjetër, e dimë që në Shqipëri nuk ka hotele dhe resorte me 5 yje? Ju thoni që do t’i mbyllni sot në një kohë kur infrastruktura nuk është e gatshme. Pra, kur themi që do të mbyllen, unë them që të mbyllen të gjitha në qytet dhe nuk ka pse të bëjmë gjëra selektive këtu, ligji të jetë i barabartë për të gjithë. Unë mendoj, pasi ju nuk i thatë emrat, se janë shumë kompani, të cilat kanë qenë shumë korrekte me shtetin dhe me mënyrën si po vepronin ju po i çoni drejt falimentimit. Të dalë me licencë një person tjetër, i cili nuk ka pasur fare lidhje me këtë punë dhe këto kontribute, mendoj se kjo duhet parë mirë si për të mirën edhe për të ardhurat që merr shteti. Në qoftë se ju thoni resort dhe hotel me 5 yje, po ju them se në Shqipëri nuk ka hotele dhe resorte të tilla në fshatrat turistike. Më thoni një rast që ta di edhe unë?

Fatmir Xhafaj – Mos bëni pyetje sugjestionuese.

Irena Beqiraj – Kryesisht ne jemi konsultuar me ligjet e vendeve të rajonit, si dhe vende të ngjashme me ne, siç janë: Kroacia, Bullgaria, Danimarka dhe Italia për çështje të caktuara. Nuk është se kemi bërë një ligj, i cili është totalisht i ri apo ndonjë shpikje shqiptare.

Për sa i përket selektivitetit, çdo parakusht që vihet në ligj mund të përkthehet si selektivitet, sepse në qoftë se them se ai që do të ushtrojë aktivitetin e lojërave të fatit nuk do ta ketë pasur emrin asnjëherë në listat e pastrimit të parave, në njëfarë mënyre kam vënë një sit, por në qoftë se kjo do të përkthehet si selektivitet, atëherë kështu mund të përkthehen edhe ligjet, të cilat duhet të kenë në disa aktivitete të caktuara disa kushte se kush ofron një aktivitet dhe cili duhet të ofrojë një aktivitet tjetër.

Ne nuk kemi bërë asnjë lloj selektiviteti për sa i përket ligjit, në sensin që të kemi më shumë hapësira për ekzistuesit dhe më pak hapësira për ata që do të vijnë. Në qoftë se një kompani sot ka një kazino, e cila është në një vend bregdetar, po them në Voskopojë, ka hotele

dhe është jashtë vijës administrative dhe ndodhet në një zonë turistike ku pronari, përfituesit e aktivitetit dhe ortakët i plotësojnë të gjitha kushtet që vendos ligji i ri për të ofruar shërbimin e kazinove, nuk ka asnjë arsye që të mendojmë se atij do t'i hiqet licenca. Por në qoftë se është një kazino në mes të Tiranës, e cila nuk ka mundësi që të përballojë tarifën e re të licencimit, pronarët janë të dyshimtë dhe nuk dihet se ku venë paratë, mund të kenë lidhje me aktivitete të ndryshme të pastrimit të parave, atëherë ky ligj nuk e lejon dhe ky selektivitet besoj se është i shëndetshëm dhe në të mirë të të gjithë shoqërisë, edhe pse mund t'i vihet emri selektivitet. Çdokush, në njëfarë mënyrë, krijon mundësinë e selektivitetit.

Tahir Muhedini – Zonja zëvendësministre, nuk më dhatë asnjë përgjigje se ku ndodhen këto fshatra turistike, resortet dhe hotelet, e para.

Nuk po flasim për kompani të jashtëligjshme, kompani që kryejnë pastrim parash e të tjera, pasi nuk kemi pse të merremi me politikë, por po flasim teknikisht. Licencën e merr ai që i plotëson të gjitha kushtet dhe ligjet e shtetit, ndërsa ju tani thoni që deri më 31 janar këto lloj kazinosh do të mbyllen, për arsye se do të shkojnë në fshat. Unë po ju them: a ka ndonjë fshat turistik, por besoj se do të shkojnë në Durrës apo në Sarandë? Unë që jam në Tiranë për t'u argëtuar do të shkoj te gjiri i Lalzit ose në Durrës. A është kjo infrastrukturë? Unë kam mendimin që nuk është, prandaj ky nxitim kaq i madh qëndron në faktin që të jetë edhe infrastruktura e gatshme, që këto lloj kazinosh meqë nuk u dashka që të argëtohesh në mes të Tiranës, por duhet të shkosh në resorte dhe hotele me 5 yje, jua thashë haptazi që nuk ka as resorte dhe as hotele me 5 yje. Në qoftë se do të merret një vendim nga shteti, të merret për të gjitha kompanitë dhe nuk ka lidhje fare se njërit i mbaron më 31 dhjetor, dikujt tjetër më 31 gusht, sepse vendimi merret në mënyrë ligjore. Jo dikujt i mbaron licenca në vitin 2018 dhe dikujt tjetër në vitin 2017. Shteti ka interesat e veta, sepse nëpërmjet tyre ka të ardhura, ka dhe njerëz të punësuar. Ju thoni 5600, por unë them 10 mijë a më shumë njerëz janë të punësuar në këto kazino që mbajnë familjet e tyre, prandaj pse ky nxitim? Çfarë interesi ka shteti? Ju si përfaqësuese e Ministrisë së Financave e dini që ato derdhen të ardhurat dhe pse e detyroni dikë që kërkon të argëtohet të ikë nga Tirana në Mal të Zi. Ju nuk e thatë që Mali i Zi apo Kroacia i kanë kazinotë në qendër. Unë mendoj se duhet të jemi të saktë, të zbatojmë ligjet duke i shërbyer edhe shtetit, edhe çdo gjëje.

Më thoni ku janë këto hotele dhe resorte që në datën 31 janar të vitit 2016, do të mbyllen të gjitha kazinotë?

Fatmir Xhafaj – Zoti Muhedini, është ndër të vetmit që nuk ndërpret asnjë koleg kur ai është duke folur.

Do të përgjigjeni ju zonjë? Mund të më thoni emrin dhe mbiemrin.

Denada Stoja – Unë quhem Denada Stoja, përfaqësuese e lojërave të fatit.

Ideja e ligjit është që lojërat e fatit të jenë në funksion të turizmit, por kjo nuk do të thotë që duhet të vendosen patjetër në hotele me 5 yje. Ligji në të gjitha kategorizimet e tij flet për hotele me 5 yje, resorte dhe zona turistike. Përcaktimi i zonave turistike do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozuesit e ligjit nuk mund të përcaktojnë se ku janë zonat turistike, sepse nuk kanë as kompetencën dhe as aftësitë që t'i përcaktojnë këto zona turistike. E para.

E dyta, infrastrukturën besoj që subjektet, ashtu siç e kanë ngritur deri sot, duke hapur salla në të gjitha qytetet, duke përcaktuar zona dhe pa zona, në të gjithë nëpër lagje kemi kazino dhe bingo, gjë që është e padrejtë për pjesën sociale të qytetarëve, ashtu do t'i ngrenë edhe në vendet që kanë interes. Ideja nuk është që të hiqen këto subjekte që janë sot në treg dhe të vijnë të tjera, por këto që janë në qoftë se plotësojnë kushtet dhe kanë mundësitë financiare, të zhvendosen dhe të bëjnë investime në zonat ku përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo është e gjithë ideja.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A keni ndonjë pyetje tjetër?

Tahir Muhedini – Para disa kohësh këtu ka ardhur ministri dhe sot ndodhet zëvendësministrja, si dhe persona të tjerë. Ministri ka thënë konkretisht: “Duhet të jenë hotele me 5 yje dhe nuk lejohet asnjë hotel me 4 yje”. Ndërsa ju thoni se nuk ka problem se është me 5 yje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, por unë po them se çfarë ka thënë ministri dhe jo se çfarë thoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Tahir Muhedini – Pa këto kazino që do të mbyllen dhe këta njerëz që do të argëtohen, a është e gatshme kjo infrastrukturë për t'i hequr nga këtu dhe për t'i çuar atje ku mendoni ju, sipas Këshillit të Ministrave? Unë po jua them haptazi se nuk ka asnjë hotel me 5 yje dhe asnjë resort. Ju thoni se kazinotë do t'i çojmë në resorte dhe hotele me 5 yje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni ju një përgjigje?

Enis Tushi – Unë quhem Enis Tushi dhe jam përfaqësues i Njesisë së Mbikëqyrjes për Lojërat e Fatit. Kisha diçka për pjesën e kazinosë dhe resort kazinotë. Projektligji ka parashikuar dy definicione, përkrahje dhe kritere të ndryshme për të marrë licencën për kazino dhe për resort-kazino. Kështu që do t'u lihet mundësia kazinovë aktuale apo kujt do që

do të konkurrojnë në këtë fushë, që të kenë të drejtën të marrë një licencë kazino në zonat turistike. Por e njëjta gjë do të ndodhë edhe me resort-kazinotë, të cilat do të kenë lehtësira të tjera duke qenë se japin...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, përgjigjuni pyetjes dhe mos bëni replikë me deputetët.

Enis Tushi – Zonat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A keni pyetje të tjera, zoti Muhedini?

Tahir Muhedini – Pyetje kam, por deri tani nuk po marr asnjë përgjigje, kështu që nuk po bëj më pyetje.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ju keni të drejtën e pyetjeve, ata kanë të drejtën e përgjigjes.

A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Mua, në fakt, më tërhoqi vëmendjen ajo çfarë tha zoti Muhedini, duke qenë se kemi të bëjmë me një industri, por dua më shumë të pyes për veten time. Unë vë re që do të kemi një lëvizje të aktiviteteve, kam parasysh nenin 71, të të gjithë kësaj industrie nga qytetet, në drejtim të zonave që do të përcaktojnë ligji. Ju e keni vënë afatin deri më 31 janar të vitit 2016, nëse jam korrekt. Pyetja ime është: meqë kemi të bëjmë me një industri tashmë të ngritur, mos është e nevojshme që ta shtyjmë një vit? Kjo ideja ime për ta propozuar këtë edhe për kolegët, për ta shtyrë deri më 31 janar të vitit 2017. Pra, industrisë i themi që ke kohë në mënyrë të ngadaltë dhe normale, pasi jetojmë në një situatë, ku ju si zëvendësministre e Financave e dini shumë mirë që bankat pothuajse i kanë bllokuar kreditë dhe ai që do të investojë do ta ketë pak të vështirë për të bërë këtë lëvizje e kështu me radhë. Duke qenë se kemi të bëjmë me një industri taksapaguese, ju e thatë vetë shifrën, si e shihni këtë propozim?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko.

Zonja zëvendësministre për pyetjen dhe komentin që e shoqëroi!

Irena Beqiraj – Ligji i parë për të cilin unë kam ardhur në këtë godinë ka qenë pikërisht ky ligj dhe nuk do ta harroj kurrë, pasi ka qenë fillimi im si zëvendësministre në janar të vitit 2015.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, mos bëni replikë!

Irena Beqiraj – Mendohej që ky ligj duhet të kishte kaluar në shkurt apo mars të vitit 2015 dhe deri më 31 janar të vitit 2016 ishte gati një vit. Për arsye që pak a shumë të gjithë i dimë, për debatin që ka ngjallur ky ligj, interesin që ka pasur, ne sot jemi në nëntor dhe unë

jam e sigurt që kjo periudhë do të rishikohet për të dhënë këtë mundësi që ju, zoti Majko, propozoni.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë për ta përmbyllur.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

2 abstenime.

Meqenëse i bëra atë pyetje do të shoh reagimin dhe më pas mund të votoj pro apo kundër, kjo është në varësi sipas neneve.

Atëherë e mbyllim këtu mbledhjen.

Ditën e premte, pas seancës dëgjimore, do të përmbyllim diskutimin nen për nen të ligjit “Për pronat”. Duhet t’i përmbyllim të gjitha projektligjet që kemi në proces edhe për shkak se fillon diskutimi për projektbuxhetin e shtetit, si dhe ligjin e rëndësishëm për qeverisjen vendore.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET